

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5852
E enjte, 15 gusht 2019
çmimi 0.40 €

Në QKUK u shpëtuan gjashtë pacientë me infarkt të miokardit

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BLERIM REKA | FAQE 4-5

Qëndrimi i Quintit dha shpresë për rifillimin e dialogut

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, ka bërë me dije se qëndrimi i fundit i vendeve të Quintit ndaj dialogut Kosovë - Serbi ka dhënë shpresë për rifillimin e këtij procesi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Reka ka deklaruar se Quinti ktheu simetrinë ndaj trajtimit të të dy

palëve me dy kërkesa, duke kërkuar koncesione reciproke për secilën prej tyre. Sipas tij, deri më tani Brukseli kërkonte koncesione vetëm nga Kosova që ta hiqte taksën, por jo edhe nga Serbia që t'i hiqte bllokadat diplomatike për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare



OPINION

TË GJITHË I FITOJNË ZGJEDHJET, VETËM NJË PARTI APO KOALICION DO TË JETË FITUES

 F. 13

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



AKTUALE

TË BURGOSURIT NË BURGUN E SIGURISË SË LARTË PRODHOJNË SHTRËTËR NGA DRURI

 F. 6

GASHI: SHOIPTARËT E LUGINËS DO TA KENË VËMENDJEN E INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS

 F. 5

EKONOMI

KUSH E MBRON SEKTORIN PRIVAT NË KOSOVË?

 F. 8

Shkruan: Safet GËRHXHALIU



GAP-I THOTË SE KA NGEÇJE NË DIGJITALIZIMIN E SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

 F. 9

KULTURË

VENDOSËT GURTHEMELI I SHTËPISË MUZE TË KULLËS SË ATDHETARIT SHABAN MANGJOLLI

 F. 7

SPORT

SHABANI: DRITA DO TË LUFTOJË PËR TITULL DHE KUPË

 F. 18

Përfaqësuesit e subjekteve politike thonë se zgjedhjet janë e vetmja zgjidhje

 | FAQE 3

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare janë e vetmja zgjidhje për vendin. Kështu kanë deklaruar përfaqësuesit e partive politike të mërkurën në tryezën e organizuar nga Kolegji Riinvest me temë "Çfarë zgjidhje ofrojnë zgjedhjet". Ata kanë thënë se do të ishte mirë që në zgjedhjet e vjeshtës secila parti të garojë e vetme në mënyrë që të shihet forca e tyre politike, megjithatë nuk e kanë përjashtuar mundësinë e koalicioneve parazgjedhore

Lirohet ish-ushtari i UÇK-së, Tomor Morina



FAQE 2

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ambasadori britanik tregon cila ka qenë porosia e vendeve të Quintit

PRISHTINË, 14 GUSHT - Ambasadori britanik në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka reaguar pas interpretimeve të ndryshme të deklaratës së vendeve të Quintit (Shteteve të Bashkuara, Mbretërisë së Bashkuar, Francës, Gjermanisë dhe Italisë) një ditë më parë, për vazhdimin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian.

Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", Connell ka thënë se çështja e mbajtjes së zgjedhjeve ose jo i përket vetëm Kosovës. "Unë po lexoj 'komentatorët' që pretendojnë se deklarata e Quintit ka qenë



thirrje për formim të qeverisë së re pa zgjedhje. Pse gazetaret publikojnë gjëra të pakuptimta, pa na pyetur se çfarë mendojmë? Prandaj qytetarët e Kosovës shpesh ndihen të keqinformuar", ka thënë ai.

Ambasadori britanik ka vlerësuar se rikthimi i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse është në interes të Kosovës dhe gjithë rajonit. Prandaj, sipas tij, miqtë

e Kosovës "kërkojnë që ky shtet të jetë gati të bisedojë seriozisht sa më shpejt që është e mundur".

Një ditë më parë, përmes një komunikate, vendet e Quintit kanë kërkuar nga Kosova dhe Serbia t'i shmangin veprimet që do ta pengonin një marrëveshje përfundimtare që, siç thuhet, "është e nevojshme për të dyja vendet për të arritur integrim më të madh euroatlantik dhe përfitime përcjellëse".

Vendet e Quintit kanë theksuar se një gjë të tillë mund ta bëjnë vetëm kur palët të japin shenja të gatishmërisë për kompromis, për heqjen e pengesave

dhe rifillimin e bisedimeve. Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se pozicioni i Kosovës është i qartë në këtë proces. "Qëndrimi ynë tashmë është i qartë: Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të rifillojë pa kushte deri në arritjen e marrëveshjes për njohje reciproke në kufijtë ekzistues dhe besoj se Bashkimi Evropian do të reflektojë për shkaqet e devijimit të dialogut dhe do t'i shtojë përpjekjet për evitimin e temave, siç është shkëmbimi i territoreve e që shprijnë në destabilizimin e rajonit tonë", ka thënë Haradinaj.

Lirohet ish-ushtari i UÇK-së, Tomor Morina

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

SHKUP, 14 GUSHT - Gjykata Supreme e Maqedonisë së Veriut ka vërtetuar vendimin e Këshillit Penal për krim të organizuar dhe korrupsion pranë Gjykatës Penale Shkup, se nuk janë përbushur kushtet për ekstradimin e ish-pjesëtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Tomor Morina, në Serbi. "Në përputhje me përcaktimet e Ligjit për bashkëpunim ndërkombëtar në materien penale dhe Konventën Evropiane për ekstradim... Këshilli Penal ka gjetur se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për ekstradimin e personit T. M.", thuhet në komunikatën e Gjykatës Supreme.

Menjëherë pas këtij vendimi, ambasadori i Kosovës në Maqedoninë e Veriut, Gjergj Dedaj, ka bërë me dije se është liruar nga paraburgimi ish-luftëtar i UÇK-së, Tomor Morina. Me këtë rast, Dedaj ka falënderuar Maqedoninë e Veriut për qasjen konstruktive dhe korrekte në raport me trajtimin e këtij rasti. Ndërkaq zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Behgjet Pacolli, nëpërmjet një statusi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se është i lumtur që



gjykatat në Maqedoninë e Veriut kanë vendosur për lirimin e Tomor Morinës dhe refuzimin e kërkesës serbe për ekstradim. "Unë jam mirënjohës ndaj autoriteteve të Maqedonisë së Veriut për vendimin parimor të

marrë në lidhje me këtë çështje dhe bashkëpunimin që kemi pasur për ta zgjidhur atë në mënyrën më të mirë", ka shkruar Pacolli.

Tomor Morina ishte arrestuar nga policia maqedonase më 24

korrik, në bazë të një fletarrestimi të Interpolit, të lëshuar me kërkesë të Serbisë.

Morina dyshohet nga ana e autoriteteve të Serbisë se para 20 vjetëve, si pjesëtar i UÇK-së, ka bërë krime kundër popullatës

MINISTRIA E SERBISË REAGON PAS VENDIMIT PËR MOSEKSTRADIMIN E TOMOR MORINËS

Ministrja e Drejtësisë në Serbi, Nela Kuburoviq, ka thënë se vendimi i Gjykatës Supreme të Maqedonisë së Veriut, për të mos ekstraduar ish-pjesëtarin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Tomor Morina, në Serbi, sepse nuk janë plotësuar kushtet, tregon edhe një herë se politika ishte mbi ligjin dhe drejtësinë. "Ky është një turp i madh për të drejtën ndërkombëtare, por është një goditje edhe më e madhe dhe trishtim i madh për familjet e viktimave, të cilat kanë dekada në pritje të drejtësisë për të dashurit e tyre", është thënë në një deklaratë të kësaj ministrie.

civile në Kosovë. Arrestimi i tij ka shkaktuar reagime të shumta nga autoritetet në Kosovë dhe partitë politike shqiptare në Maqedoninë e Veriut, të cilat kanë kërkuar lirimin e menjëherëshëm të Morinës.

Mali i Zi ndalon pirjen e duhanit në hapësira të mbyllura publike

PODGORICË, 14 GUSHT - Mali i Zi, banorët e të cilit njihen për shifra të larta të konsumimit të duhanit në Evropë, ka ndaluar pirjen e cigares në vendet e mbyllura

publike. Sipas ligjit, që ka nisur së zbatuari nga 14 gushti, pirja e duhanit është ndaluar në të gjitha vendet e mbyllura publike, duke përfshirë kafetë, ndonëse për

kazinotë vlen rregullore tjetër. Ligji është miratuar në mënyrë anonime më 31 korrik, pasi ministri i Shëndetësisë, Kenan Hrapoviq, ka thënë se Ligji

kundër duhanit që është miratuar më 2004 nuk ka arritur pritshmëritë. Hrapoviqi ka thënë se zyra e tij "do të tentojë ta zbatojë secilën pikë të ligjit".

**EPOKA E RE**

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kolegji Riinvest ka organizuar tryezën me temë "Çfarë zgjidhje ofrojnë zgjedhjet"

Përfaqësuesit e subjekteve politike thonë se zgjedhjet janë e vetmja zgjidhje

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare janë e vetmja zgjidhje për vendin. Kështu kanë deklaruar përfaqësuesit e partive politike të mërkurën në tryezën e organizuar nga Kolegji Riinvest me temë "Çfarë zgjidhje ofrojnë zgjedhjet". Ata kanë thënë se do të ishte mirë që në zgjedhjet e vjeshtës secila parti të garojë e vetme në mënyrë që të shihet forca e tyre politike, megjithatë ata nuk kanë përjashtuar as mundësinë e koalicioneve parazgjedhore

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 14 GUSHT - Kolegji Riinvest të mërkurën ka organizuar tryezën me temë "Çfarë zgjidhje ofrojnë zgjedhjet". Në këtë tryezë i pranishëm ka qenë deputeti i LDK-së, Arben Gashi, deputetja e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, deputetja e LV-së, Albulena Haxhiu dhe deputeti i AAK-së, Ahmet Isufi. Panelistët e kësaj tryeze janë pajtuar që mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme në vjeshtë është e vetmja zgjidhje për vendin. Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, ka thënë se, pas dorëheqjes së kryeministrit Haradinajt dhe caktimit të seancës për shpërndarjen e Kuvendit, ka mbetur në duar të sovranit që të vendosë për përbërjen e re të qeverisë. Sipas tij, tani është koha që të mbahen zgjedhjet e reja. "Kjo është situatë e re politike e cila kërkon t'i kthehemi sovranit. Me dorëheqjen e Haradinajt

është krijuar situatë e re politike dhe partitë politike kanë vendosur që më 22 gusht të shpërndahet Kuvendi dhe të mbahen zgjedhjet në fund të shtatorit, përkatësisht më 22 apo 29 shtator nëse shpërndahet Kuvendi", ka deklaruar ai. Gashi ka thënë se do të ishte mirë që secila parti të garojë e vetme në këto zgjedhje në mënyrë që të shihet forca e tyre politike. Megjithatë, ai ka treguar se nëse partitë e tjera vendosin të shkojnë në garë me koalicione, LDK-ja do t'u kthehet me të njëjtën monedhë duke bërë koalicion me LV-në. "Të shkojmë vetë në zgjedhje të shohim se cila parti ka forcën më të madhe dhe duke mos ditur forcën e secilës nuk mund ta dimë impaktin politik nëse do të kemi koalicion mes partive normalisht. Ne jemi për koalicion opozitar, por qëndrimin për këtë çështje duhet ta japë kryetari i LDK-së", ka theksuar Gashi. Edhe deputetja e Partisë

Demokratike të Kosovës (PDK), Blerta Deliu-Kodra, ka thënë se kjo parti nuk është për arnim të qeverisë, por për mbajtje të zgjedhjeve të parakohshme. Ajo ka bërë me dije se PDK-ja nuk ka vija të kuqe për koalicione dhe do të kandidojë me kandidatën e vet për kryeministër. "Duhet të ketë maturi politike kur flasim për koalicione. PDK-ja nuk ka vija të kuqe dhe do të kandidojë me kandidatën e vet për kryeministër. Më 22 gusht do të shohim se kur do të përcaktohet data e zgjedhjeve. Nuk është as hera e parë e as fundit që Kosova po përballet me mandate të shkurtra. Por, sidoqoftë, unë besoj se qytetarët do ta përcaktojnë fituesin. Ne kemi pritur një korrektësi si partnerë të koalicionit në kohën kur ka dhënë dorëheqje Haradinajt sepse ia kemi besuar mandatin", ka thënë Deliu-Kodra. Ajo e ka komentuar edhe takimin në mes kryetarit të LDK-së, Isa Mustafa, me liderin e LV-së, Albin Kurti. "Subjekti i Albulenës ka pasur debat të ashpër me kryetarin e LDK-së dhe tash së fundmi kemi pirje të kafeve dhe shtrëngim të duarve. Sot po ulen e po flasin dhe po mundohen të krijojnë krahë politik", është shprehur Deliu-Kodra. Ndërsa deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albulena Haxhiu, ka thënë se për këtë subjekt politik zgjedhjet e jashtëzakonshme janë e vetmja zgjidhje. Sipas saj, opozita e tanishme duhet ta qeverisë

Kosovën në mandatin e ardhshëm. "LV-ja nuk bën koalicion me PDK-në. Veseli sikur ka qenë në koma dhe tani po bën komente që duhet luftuar korrupsionin dhe duhen rikthyer të rinjtë që kanë ikur nga Kosova", është shprehur deputetja Haxhiu. Ajo ka thënë se Vetëvendosje e ka kundërshtuar datën 22 gusht për shpërndarje të Kuvendit pasi, sipas Haxhiut, partitë që janë kundër këtyre zgjedhjeve edhe mund të përfitojnë gjatë kësaj kohe për të bërë kalkulime. Ajo ka thënë se mënyra e largimit të Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit ishte e paarsyeshme. Haxhiu ka deklaruar se kjo është çështje fushate që të përfitojnë në emër të luftës së UÇK-së por, sipas saj, përfitimet në emër të luftës nuk ndezin më. "Që një vit LV-ja dhe LDK-ja kanë nisur organizimin opozitar për zgjedhje të jashtëzakonshme dhe para dorëheqjes së Haradinajt kemi pasur 58 nënshkrime. Na nevojiteshin edhe tre nënshkrime për rrëzimin e Haradinajt që do të duhej të largohej. Nuk e kemi pritur këtë mënyrë të dorëheqjes së tij. Përfitimi në emër të luftës nuk ndez më. Njerëzit në emër të luftës janë pasuruar. Ne kemi dashur një datë më të afërt për seancën e jashtëzakonshme. Janë bërë koalicionet më të çuditshme vetëm të kemi qëndrueshmërinë politike. Për LV-në zgjedhjet e jashtëzakon-

shme janë zgjidhja dhe opozita e tanishme duhet ta qeverisë vendin", ka thënë Haxhiu. Ndërsa deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ahmet Isufi, duke folur për arsyet e dorëheqjes së kryeministrit Haradinajt, ka thënë se ky vendim ka qenë i papritur dhe se as anëtarët e partisë nuk e kanë ditur paraprakisht për dorëheqjen. "Ftesa e Haradinajt ka qenë befasi për të gjithë sepse Haradinajt ka qenë emri më së paku që kemi menduar se mundet me qenë. Dorëheqjen e tij e kemi kuptuar kur e ka deklaruar në qeveri. Së pari duhet të jemi njerëz e pastaj udhëheqës politikë, sepse të gjithë e dimë se çfarë ka hequr Haradinajt dhe nuk duhet t'i marrim pa ndjenja situatat nëpër të cilat ka kaluar ai dhe Kosova", ka thënë Isufi, duke shtuar se të gjitha partitë politike tashmë janë pajtuar se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme. "Duhet të shkojmë në zgjedhje sepse të gjitha partitë politike janë pajtuar", ka thënë ai. Kurse sa iu përket koalicioneve parazgjedhore, Isufi nuk e ka përjashtuar një të tillë me Nismën dhe PSD-në. "Me Nismën dhe me PSD-në ka mundësi të kemi koalicion. Kundërshtarët politikë ndoshta nuk e kanë të lehtë ta përballojnë këtë. AAK-ja nuk ka vija të kuqe për askënd, madje as për PDK-në", ka theksuar Isufi, duke shtuar se koalicionet do të bëhen me parti që janë kundër heqjes së taksës.



Flet për "Epokën e re", Blerim Reka

Qëndrimi i Quintit dha shpre

Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, ka bërë me dije se qëndrimi i fundit i vendeve të Quintit ndaj dialogut Kosovë - Serbi ka dhënë shpresë për rifillimin e këtij procesi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Reka ka deklaruar se Quinti ktheu simetrinë ndaj trajtimit të të dy palëve me dy kërkesa, duke kërkuar koncesione reciproke për secilën prej tyre. Sipas tij, deri më tani Brukseli kërkonte koncesione vetëm nga Kosova që ta hiqte taksën, por jo edhe nga Serbia që t'i hiqte bllokadat diplomatike për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 14 GUSHT - Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Blerim Reka, e ka përshëndetur deklaratën e përbashkët e vendeve të Quintit, në të cilën kërkohet që Kosova ta heqë taksën dhe Serbia ta ndalë ofensivën diplomatike ndaj Kosovës në mënyrë që të rifillojë dialogu. Ai ka deklaruar se me këtë qëndrim vendet e Quintit po i trajtojnë palët në mënyrë të barabartë, gjë të cilën deri më tani nuk e ka bërë BE-ja.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Reka ka thënë se tani u kërkohet koncesione të dyja palëve. "Quinti më në fund e bëri atë që nuk e bënte BE-ja: ktheu simetrinë ndaj trajtimit të të dy palëve me dy kërkesa: koncesione reciproke për secilën prej tyre. Deri më tash Brukseli kërkonte koncesione vetëm nga njëra palë, pra që vetëm Kosova ta hiqte taksën, por jo edhe që Serbia t'i hiqte bllokadat diplomatike për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare", ka thënë Reka. Ai ka bërë me dije se me këtë qëndrim vendet më të fuqishme perëndimore kanë dhënë shpresë për një rifillim të dialogut me një mandat të ri. "Konsideroj se Quinti, me një qëndrim të tillë të ekuidistancës ndaj dy palëve të barabarta negociuese, dha shpresë për rifillimin e dialogut, por tash me: një mandat të ri, format të ri dhe me trajtim të ri të barabartë ndaj dy palëve negociuese. Fundja, qëndrimin e Quintit pak a shumë e kishte paralajmëruar iniciativa e fundit Merkel - Makron, e filluar në pranverë në Berlin dhe me gjasë me vazhdim në vjeshtë në Paris", është shprehur ai.

Reka ka kritikuar qasjen e deritashme të dialogut Kosovë - Serbi për normalizim të marrëdhënieve. Sipas tij, edhe iniciativa e kance-



lares gjermane dhe presidentit francez ishte kundër qasjes së deritashme të këtij dialogu. "Dueti 'Merkron' i dy fuqive kryesore të BE-së në një mënyrë ishte kritikë ndaj qasjes së gjertanishme shtatëvjeçare të ndërmjetësimit të dialogut të Brukselit, sidomos të rrëshqitjes së ish-ndërmjetësues së tij (nga gushti i vitit të kaluar) në pranimin implicit edhe të negociimit të ndryshimeve kufitare, që nuk ishte as mandat i saj e as i Komisionit Evropian", ka thënë Reka

"Epoka e re": Z. Reka, dialogu Kosovë - Serbi është bllokuar për arsye që dihen tashmë. Si e

shihni zhbllokimin e këtij procesi? Reka: Po, dialogu i Brukselit është ndërprerë tash e një vit. Shkak për ndërprerjen e tij kryesisht u dha ajo që mund të quhet vetëm pasojë, por jo shkak i vërtetë. Ky dialog që në start dihej se do të ndërpritej. Bile ishte befasi që zgjati aq shumë. Pas dy fazave të tij, teknikes dhe të asaj politike, ai u ndal që nga gushti i vitit të kaluar në fazën e tretë, apo siç quhej "faza finale". Për shtatë vjet, si proces negociator, ai u ndërmjetësua nga Komisioni Evropian, i cili deklarohet si mediator neutral, ndërkaq që nga fillimi mbajti pozicion neutral ndaj statusit të njëjës palë, Republikës së Kosovës.

BE-ja pra aplikoi neutralitetin asimetric në këto negociata, duke e trajtuar njëjën palë si shtet, kurse tjetrën një entitet - siç shprehej vetë: "Pa prejudikuar statusin". Brukseli pra aprovoi qëndrimin e palës tjetër negociatore Serbisë: mosnjohjen e Republikës së Kosovës duke ndërmjetësuar asimetricisht me këtë dialog. Pos këtij qëndrimi kontradiktor politik, BE-ja me fusnotën (*) për Kosovën mbajti edhe qëndrim kontradiktor juridik. Thirrej në Rezolutën 1244/99 të OKB-së, (e cila Kosovën e "mban" ende "pjesë" te një shteti që nuk ekziston më "RFJ"(!), ndërkohë që vetë organi gjyqësor i OKB-së -

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, qartë konstatoi se deklarimi i pavarësisë nuk shkeli të drejtën ndërkombëtare. Pra, gabimi fillestar i BE-së, kur i referohej statusit të Kosovës, ishte që thirrej njëkohësisht në dy dokumente kundërthënëse të OKB-së: edhe dokumentit virtual të para dy dekadave që mbante Kosovën në një krijesë shtetërore të shuar qëmoti, edhe dokumentit real të OKB-së - atij të vitit 2010, që njohu realitetin e ri dhe juridikisht korrigjoi një non sens të Këshillit të Sigurimit. Fundja, edhe maksima e moçme juridike na mëson se ligji i mëvonshëm e dërgon të mëparshmin.

së për rifillimin e dialogut

njërit shtet. Ky është pra shkaku i vërtetë i ndërprerjes së këtij dialogu dhe jo taksa që ishte pasojë e këtij neutraliteti asimetrik të këtij dialogu, apo ta them si ndezje alarmi nga Prishtina e kështu nuk mund të vazhdojë ky dialog pa trajtim të barabartë të dy palëve negociuese.

"Epoka e re": Ndonëse Kosova është në prag të zgjedhjeve të parakohshme, vendet e Quintit sërish i kanë bërë thirrje Kosovës që ta heqë taksën dhe Serbisë që ta ndalë fushatën diplomatike kundër Kosovës, në mënyrë që urgjentisht t'i kthehen dialogut. Si e keni parë këtë qëndrim të Quintit?

Reka: Quinti e gjen Kosovën në një vakuum qeverisës: me një qeveri në dorëheqje, me një Kuvend që pret seancën vendimtare dhe me partitë politike që nuk dinë nëse janë për zgjedhje të parakohshme apo për, siç quhet, qeveri teknike? Po, Quinti, më në fund, e bëri atë që nuk e bënte BE-ja: ktheu simetrinë ndaj trajtimit të të dy palëve me dy kërkesa: koncesione reciproke për secilën prej tyre. Deri më tash Brukseli kërkonte koncesione vetëm nga njëra palë, pra që vetëm Kosova ta hiqte taksën, por jo edhe që Serbia t'i hiqte bllokat diplomatike për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare (ndryshe një obligim i saj nga "Marrëveshja e Brukselit" 2013).

"Epoka e re": A do të thotë kjo se bashkësia ndërkombëtare tani ka ndryshuar qasje ndaj këtij procesi?

Reka: Konsideroj se Quinti, me një qëndrim të tillë të ekuidistancës ndaj dy palëve të barabarta negociuese, dha shpresë për rifillimin e dialogut, por tash me: një mandat të ri, format të ri dhe me trajtim të ri të barabartë ndaj dy palëve negociuese. Fundja, qëndrimin e Quintit pak a shumë e kishte paralajmëruar iniciativa e fundit Merkel - Makron, e filluar në pranverë në Berlin dhe me gjasë me vazhdim në vjeshtë në Paris. Dueti 'Merkron' i dy fuqive kryesore të BE-së, në një mënyrë ishte kritikë ndaj qasjes së gjertanishme shtatëvjeçare të ndërmjetësimit të Dialogut të Brukselit, sidomos të rrëshqitjes së ish-ndërmjetësues së tij (nga gushti i vitit të kaluar) në pranimin implicit edhe të negociimit të ndryshimeve kufitare, që nuk ishte as mandat i saj e as i Komisionit Evropian.

"Epoka e re": Në Kosovë shpesh thuhet se BE-ja po e ndërlikon liberalizimin e vizave me dialogun

Kosovë - Serbi. Si njohës i integriteteve evropiane, a përdodh kjo dhe sa është e drejtë që lëvizja e qytetarëve të Kosovës në Zonën Shengen të kushtëzohet me rezultatet e dialogut me Serbinë?

Reka: Jo, liberalizimi i vizave është çështje teknike për të cilën vendoset me shumicë votash dhe jo me konsensus të shteteve anëtare, pra pa veto.

Me sa e di, 95 kriteret e kërkuara nga KE-ja për liberalizimin e vizave janë plotësuar nga Prishtina, por mbeten që të binden dy shtete anëtare që kanë ende dyshime për rezultatet në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ndryshe, nëse doni mendimin tim, po e përsëris vetëm atë që e kam thënë shumë herë më parë, se vërtet

është absurde që Kosova, që është në kuadër të politikës së zgjerimit të BE-së, pas heqjes së vizave për të gjitha shtetet e tjera të Ballkanit, të mbetet geto e mbyllur jashtë qarkullimit të lirë. Ndërkohë që Brukseli para ca vitesh ua hoqi vizat edhe shteteve që nuk janë fare në politikën e zgjerimit, por në atë të partneritetit lindor (Moldavi, Gjeorgji apo Ukrainë).

Gashi: Shqiptarët e Luginës do ta kenë vëmendjen e institucioneve të Kosovës

PRISHTINË, 14 GUSHT (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësuesit e institucioneve të kulturës nga Lugina e Preshevës. Në një ceremoni solemne ai ka bërë shpërndarjen 135 titujve të librave të blerë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Me këtë rast, ministri Gashi ka thënë se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të vazhdojë t'i mbështesë të gjitha institucionet dhe bibliotekat me furnizim me libra, me theks të veçantë institucionet

shqiptare të kulturës në komunat e Luginës së Preshevës.

Gashi ka shprehur përkushtimin e tij dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ta thelluar bashkëpunimin në mes të institucioneve të Kosovës dhe komunave të Luginës së Preshevës, veçmas në fushat që lidhen me kulturën, rininë dhe sportin. "Si MKRS ndër prioritetet tona kemi përkrahjen e librit nëpër të gjitha qendrat regjionale të Kosovës, por vëmendja jonë është edhe për shqiptarët të cilët jetojnë në Preshevë,

Medvegjë dhe Bujanovc ashtu që libri dhe aktivitetet që nxisin dashurinë për librin, për leximin, të jenë më afër qytetarëve", ka thënë Gashi. Ndërsa përfaqësuesit e institucioneve të kulturës nga Kosova Lindore, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, janë shprehur të kënaqur që për herë të parë kanë zhvilluar një takim me ministrin e Kulturës së Kosovës, duke falënderuar ministrin Gashi dhe institucionet shtetërore për mbështetjen e qytetarëve shqiptarë të cilët jetojnë në Kosovën Lindore.



"Epoka e re": Pra, mendoni se dialogu i Brukselit nuk duhet të vazhdojë në mënyrë të deritashme?

Reka: Prandaj, ky dialog i Brukselit edhe nuk mund të vazhdonte me këtë mandat, në këtë format dhe sigurisht jo me një qasje të tillë të neutralitetit asimetrik për, siç thuhej, "normalizimin" e marrëdhënies të dy palëve negociuese. Asnjëherë nuk u tha se çka nënkupton ky normalizim. Serbia e trajtoi atë si dialog teknik, kurse Kosova si negociata midis dy shteteve. Mirëpo, sa kalonte koha, ky dialog, nga negociim i dy shteteve, rrezikonte në fund të përfundonte në negociata për statusin e

Përfundoi shkolla verore për nxënësit nga diaspora

PEJË, 14 GUSHT (ER) - Organizuar nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, pas pesë ditëve me plot aktivitete, ka përfunduar me sukses shkolla verore 2019. Shkolla verore u mbajt në Rugovë, nga data 5 deri më 9 gusht. Në të morën pjesë 37 nxënës dhe mësues nga diaspora dhe Kosova. Me aktivitete të shumta që kishin për qëllim zhvillimin e

personalitetit dhe shkathtësive të nxënësve, zhvillimin e mendimit kritik dhe kreativ, socializimin dhe krijimin e shoqërive të reja e shumë aktivitete të tjera atraktive dhe sportive, nxënësit sfiduan njëri-tjetrin duke e bërë kështu shkollën verore njërin nga përjetimet më të mira të kësaj vere.


Krahas tyre, ata vizituan bukuritë natyrore, si Grykën e

Rugovës e Valbonën, ku u njohën me gjeografinë dhe relievin e këtyre anëve.

Ruajtja e identitetit kombëtar, gjuhësor dhe kulturor, shkëmbimi i përvojave dhe kulturave të ndryshme, socializimi dhe krijimi i lidhjeve të reja shoqërore ishin disa nga qëllimet që u arritën falë angazhimit të të gjithë atyre që kontribuan për realizimin e kësaj shkolle.



Të burgosurit në Burgun e Sigurisë së Lartë prodhojnë shtretër nga druri



EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 14 GUSHT - Në vazhden e aktiviteteve të punës së organizuar nëpër burgje, të mbështetur nga organizata joqeveritare "Help

Kosovo", të burgosurit e Burgut të Sigurisë së Lartë kanë filluar prodhimin e shtretërve nga druri.

Të burgosurit e BSL-së, përveçse kanë aktivitete të shumta sportive, ata zhvillojnë edhe aktivitete të tjera, me të

cilat shprehin talentin në punën dhe zanatet e tyre që ata zotërojnë. Përmes këtij projekti synohet të ndikohet në rehabilitimin dhe risocializimin e personave të burgosur. Qëllimi i projektit është ngritja e kapaciteteve të grupeve të

cenueshme në sferën ekonomike dhe shoqërore, në mënyrë që t'u krijohen mundësitë për pjesëmarrje aktive në shoqëri. Kjo përmirëson mundësitë e të burgosurit për të jetuar edhe pas lirim. Përveç kësaj, puna normalizon

jetën e përditshme në burg. Secili punim i kryer nga të burgosurit në punëtoritë e ShKK-së, kryesisht përdoret për nevojat e qendrave korrektuese dhe atyre të paraburgimit. Disa prej tyre jepen edhe donacion.

Kosnetti në Krushë të Madhe: ShBA-ja do të angazhohet në çështjen e personave të zhdukur

RAHOVEC, 14 GUSHT - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë (ShBA), Philip Kosnett, të mërkurën ka vizituar kompleksin memorial në Krushë të Madhe. Me këtë rast, kryetari i fshatit, Selami Hoti, e ka njoftu-

ar ambasadorin amerikan për historinë e 64 personave të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Diplomati amerikan ka bërë me dije se ShBA-ja do të angazhohet për zgjidhjen e kësaj çështje. "E di që keni

marrë shumë premtime andaj nuk dua ta bëj një të tillë, por Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të angazhohen që në bashkëpunim me Serbinë ta zgjidhin çështjen e personave të zhdukur gjatë luftës", ka thënë Kosnett.



Teatrot e Kosovës bashkojnë forcat për showcase-in teatror 2019



PRISHTINË, 14 GUSHT (ER) - Teatri Kombëtar i Kosovës, Teatri "Adriana" i Ferizajt, Teatri i Gjilanit dhe Qendra Multimedia nga Prishtina kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi me të cilin zotohen të angazhohen bashkër-

isht për organizimin e edicionit të sivjetshëm të Kosovo Theater Showcase 2019, që sivjet do të mbahet nga data 31 tetor deri më 4 nëntor 2019. Në këtë edicion pritet të prezantohen së paku gjashtë shfaqje të prodhuara nga

teatrot nënshkruese të këtij memorandum. Edicioni i sivjetshëm i showcase-it 2019 pritet të sjellë në Kosovë rreth 50 kritikë teatri, gazetarë, selektorë festivalesh e admirues të teatrit nga vende të ndryshme të botës.

Në QKUK u shpëtuan gjashtë pacientë me infarkt të miokardit

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se është arritur mjaft në fushën e kardiologjisë invazive, ngaqë falë punës dhe angazhimit edhe të stafit mjekësor, është krijuar shërbimi për stentim 24 orë, shtatë ditë në javë. Ai ka bërë me dije se në QKUK u shpëtuan gjashtë pacientë me infarkt të miokardit brenda dy orëve të para

**EPOKA
ERE****Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 14 GUSHT - Janë prezantuar rezultatet e para të programit në nivel kombëtar për trajtimin e infarktit të miokardit brenda dy orëve të para. Gjatë prezantimit të këtyre rezultateve, ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se është arritur mjaft në fushën e kardiologjisë invazive, ngaqë falë punës dhe angazhimit edhe të stafit mjekësor, është krijuar shërbimi për stentim 24 orë, shtatë ditë në javë. Sipas Ismailit, me këtë është arritur të kursethet buxheti, të shpëtohet xhepi i qytetarëve, por edhe të pamundësohet zhvillimi i korrupsionit. "Sot po ia bashkëngjisim një sukses tjetër, një program më të ri për trajtimin e sulmeve në zemër për dy orët e para. Pra, një person kur ka sulm në zemër, krejt zinxhiri hyn në funksion që ai të vijë drejtpërdrejt në sallë, mos të ketë vonesa dhe pengesa, mos të silltet nga zyra në zyrë, pra shërbimi të merret brenda dy orëve. Ky projekt nuk ka ekzistuar më parë. Projekti është testuar në Komunën e Prishtinës, ku

kanë përfutur gjashtë pacientë me gjendje kritike, brenda dy orëve, ata kanë ardhur këtu, personeli ka bërë trajtimin e tyre. Ky shërbim shpëton jetë, kursen para, ndalon korrupsionin", ka theksuar ministri Ismaili. Ai ka deklaruar se për herë të parë është arritur një lidhje e drejtpërdrejtë e sistemeve shëndetësore, atij primar dhe terciar, ku po kurorëzohen rezultatet që krijojnë siguri të pacientët që kanë sulme në zemër. Sipas Ismailit, tani Shërbimi i Kardiologjisë Invazive ka arritur numër rekord të stentimeve dhe koronarografive. Në anën tjetër, dr. Basri Sejdiu, drejtor i përgjithshëm i ShSKUK-së, ka thënë se që nga fillimi ka qenë i mishëruar me këtë shërbim, kanë kaluar shumë sfida, është arritur qëllimi me përgatitje të stafit dhe infrastrukturë dhe me resurse humane. "Trajtimi në dy orët e para na bënë krenarë. I tejkalojmë vendet e regjionit. Ato nuk e kanë këtë program. Është krijuar mundësia që pacienti nga çdo skaj të mbërrijë në dy orët e para. Kjo sëmundje është problematike në tërë botën, por ne po arrijmë suksese të moshat e reja. Kjo shpëton jetë dhe



shumë persona nga invaliditeti, sidomos moshat e reja dhe ata të aftë për punë", është shprehur Sejdiu.

Më tutje, Sejdiu ka theksuar se pacientët që kanë dhimbje gjoksi me një EKG vijnë drejtpërdrejt në sallë të kateterizimit, anashkalohet marrja e udhëzimit dhe emergjenca.

Dr. Tefik Bekteshi, drejtor i Shërbimit Klinik të Kardiokirurgjisë me Kardiologji Invazive, duke sqaruar aspektet profesionale, ka pohuar se infarkti i miokardit shkakton mbyllje të arteries që furnizon muskulin e zemrës. Ai ka thënë

se me mjaft sukses është arritur të hapen arteriet të gjashtë rastet e para, edhe pse tri prej këtyre rasteve ishin mjaft të komplikuar. "Krejt esenca është ta hapin në mënyrë mekanike arterien përmes vendosjes së stentes, pra intervenimi bëhet aty ku është mbyllur arteria. Për dy vjet kemi punuar shumë, kemi ngritur sistemin publik në nivel që të absorbojë pacientë për sistemin kardiovaskular, kemi punuar shumë, jemi kthyer nga mjekësia primare, ku kemi pasur mbështetje nga stafi, kemi bërë disa trajnime, kemi filluar projektin në

Komunën e Prishtinës", ka thënë Bekteshi.

Dr. Agron Qerimi, shef i Shërbimit të Kardiologjisë Invazive, ka theksuar se në katër pacientë, në të cilët është intervenuar në dy orët e para, gjendja e tyre ka qenë e komplikuar, tre prej tyre me çrregullime të ritmit. Ai përcolli një mesazh të popullata, që në rastet kur kanë dhimbje gjoksi, të lajmërohen te mjeku më i afërt dhe të bëhet EKG për verifikim. Programi në nivel kombëtar për trajtimin e infarktit të miokardit brenda dy orëve të para pritet të zgjerohet në tërë Kosovën.

Vendoset gurthemeli i shtëpisë muze të kullës së atdhetarit Shaban Mangjollli

SKENDERAJ, 14 GUSHT (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, mori pjesë të mërkurën në vënie e gurthemelit të kullës së Shaban Manxhollit në Mikushnicë. Me këtë rast, ministri Gashi ka thënë se njëzetë vjet pas çlirimit të Kosovës, dekada të tëra pas luftërave të Azem Bejtës, Shaban Polluzhës, Tahir Mehës, kryetrim-it të UÇK-së, Adem Jasharit, tani po vendosin gurthemelin e shtëpisë muze, kullës të, një ndër luftëtarëve më besnik të Lëvizjes Kaçake, bashkëluftëtarit të Azem Bejtës dhe Shaban Polluzhës, luftëtarit guximtar dhe sypatrembur të Drenicës dhe të mbarë shqiptarisë, atdhetarit Shaban Manxhollit. "Jeta e Shaban Manxhollit, sikur edhe e bashkëkohanikëve të tjerë trima, Ahmet Delia, Ramë Islami, Shaqir Smaka, Halit Bajrami, Hazir Rama, Kamber Loshi, Sejdi

Meta, Isuf Rexha, Shote Galica e shumë të tjerë, ishte luftë e pandalur për mbrojtjen e tokave të të parëve tanë, luftë për nderin, krenarinë e rrënjëve tona, gjakut, identitetit dhe emrit shqiptar", ka thënë ministri Gashi.

Ai ka shtuar se mbi themelet e kësaj shtëpie muze, kullës së Shaban Manxhollit, përjetë do të zë rrënjë edhe një copë e kujtesës sonë historike, për rrugëtimin tonë, nga robëria deri te liria, çlirimi dhe shtetndërtimi i Republikës së Kosovës. "Sa herë që rinia dhe vizitorë të tjerë të vijnë në këtë kullë të krenarisë shqiptare, gjithnjë dhe gjithmonë do ta ndiejnë se populli shqiptar lirinë e tij e shkroi me gjakun e vet", ka thënë Gashi. Të pranishëm në këtë ngjarje ishin edhe kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, si dhe deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.



KUSH E MBRON SEKTORIN PRIVAT NË KOSOVË?



Shkruan: Safet GËRXHALIU

Kanë kaluar vite të tëra pas luftës në Kosovë dhe tani kremtohet 20-vjetori i lirisë, por Kosova nuk ka qenë në pozitë më të vështirë qoftë në aspektin politik, ekonomik, social dhe integruar.

Në një shtet ku agjenda politike dominon, ndërsa politika dhe politikanët merren me vetveten, është utopike të mendohet në zhvillim ekonomik, stabilitet social, në përshpejtim të proceseve integruese dhe në përmirësim të imazhit të Kosovës. Ajo çka dhemb më së shumti është fakti se për çdo dështim tentohet të fajësohen të tjerët, ndërsa problemi jemi ne dhe është Kosova.

Humbet kohë në tentim për të hijeshuar të kaluarën me qëllim të rritjes së populzimit inekzis-

tent dhe në gërshetim të këtyre rrethanave enorm negative për Kosovën është duke lulëzuar krimi, kontrabanda, degradimi i vlerave, politizimi i skajshëm i çdo gjëje që quhet publike dhe shtetërore.

Në veçanti po shihet një qasje agresive për të dëmtuar bizneset e mirëfillta apolitike përmes shantazhit, presionit, mitos dhe korrupsionit, që sot është në shkallën më të lartë të zhvillimit dhe të rritjes.

Ky fenomen është duke u rritur dhe fuqizuar më shpejtë se sa vet shteti.

Derisa duartrokitën me veprime populiste, duke vendosur taksa të ndryshme kundër vendeve të rajonit me qëllim kinse të mbrojtjes së prodhimit vendor, ku Kosova dëmtohet në çdo aspekt, në veçanti izolohet nga Evropa dhe shtetet demokratike ndërkombëtare.

Koston e këtij populizmi është duke e paguar qytetari i Kosovës përmes ngritjes së çmimeve të produkteve bazike, përmes inflacionit marra-mendës edhe për kundër asaj

që valutë kemi euron. Sot falë këtij populizmi Kosova renditet në një ndër shtatë shtetet më të shtrenjta në Evropë me çmime më të larta se sa në Evropë, ndërkaq ka të hyra afrikane.

Duhet të kuptohet se kjo rrugë është mjaftë e gabuar dhe pasojat do t'i bartim të gjithë ne. Ata që sjellin vendime të tilla dhe që janë pjesë e krimin orkestrues të korrupsionit dhe kontrabandës, këtë e bëjnë për fat të keq në emër të patriotizmit folklorik në të cilin nuk beson askush përveç atyre që përfitojnë.

Falë vendimeve të tilla, Kosova është shndërruar në shtet të pashpresë dhe të paperspektivë. Këtë e dëshmon më së miri ikja e popullatës nga ky vend.

Ditëve të fundit disa biznese prodhuese më janë adresuar me ankesa të shumta, në veçanti në Doganën e Kosovës për një qasje joprofesionale, denigruese, korruptive dhe amorale. Është shqetësuese që me fenomenin e korrupsionit dhe presionit nga Dogana e Kosovës pësojnë më së shumti bizneset prodhuese me rastin e

importeve të lëndës së parë ose pajisjeve të ndryshme për prodhim, ku shumë më tepër humbet kohë për të gjetur arsye për t'i dënua se sa për t'i ndihmuar.

Në qoftë se nuk jep ryshfet do të jesh i dënua dhe arsytimi do të jetë, paguaj dënimin dhe bëje një ankesë e cila do të shqyrtohet. Hipokrizia në Kosovë nuk ka fund por të dëmtosh në këtë masë bizneset prodhuese, në të njëjtën kohë kur është vënë taksa 100 për qind kinse për të mbrojtur prodhimin vendor është një hipokrizi që dëshmon se Kosova udhëhiqet nga parlamenti dhe qeveria më e dobët në 20 vitet e fundit.

Politizimi dhe qasja ndaj institucioneve që të jenë në funksion të pushtetit nuk ka të ndalur.

Tash lind pyetja se a ka moral në këtë shtet dhe te këta pushtetarë?

A ekzistojnë asociacione të biznesit që janë "pro business" të orientuara apo të orientuara drejt servilitetit politik dhe mbrojtjes së interesave të grupeve të caktuara të interesit.

Një Kosovë pa sektor privat të zhvilluar nuk mund të mbijetojë, prandaj duhet të kuptohet se sektori privat për të përmirësuar indikatorët kryesorë ekonomikë siç është rritja e prodhimit, rritja e eksporteve, krijimi i vendeve të reja të punës dhe përmirësimi i imazhit të Kosovës përmes promovimit të brendeve "Made in Kosova" duhet të jenë prioritet për një ekonomi dhe sektor privat të zhvilluar.

Pra, nuk duhet demagogji dhe politizim steril, por hapa konkret drejt mbështetjes së tyre dhe objektivave shtetërore.

Serviliteti i tepruar dhe egoist i asociacioneve të biznesit në Kosovë përballë politikës do ta varrosë perspektivën e punësimit të të rinjve dhe do të ndikojë edhe më tepër në migrim, që kjo do të jetë edhe arritja më e madhe e kundërshtarëve të pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Emëruesi i përbashkët i zgjidhjes së gjithë këtyre problemeve është sundimi i rendit dhe ligjit, i cili lë për të dëshiruar, sepse është larg realitetit për çfarë ekziston.

Veseli: Si kryeministër i ardhshëm do ta kem prioritet përmirësimin e klimës së biznesit

Dragash, 14 gusht (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka vizituar kompaninë "Meka". Ai ka bërë me dije se ka pasur një takim shumë të frytshëm në kompaninë "Meka" që merret me përpunimin e mishit dhe është një ndër prodhuesit më të njohur, duke bërë të pranishme produktet "Made in Kosova" në shumë tregje të huaja. "Falë suksesit të kësaj kompanie punësohen mbi 100 banorë të zonës duke kontribuar ndjeshëm në mirëqenien e komunitetit. Si kryeministër i ardhshëm i vendit do ta kem prioritet heqjen e barrierave burokratike dhe përmirësimin e klimës së biznesit për kompani prodhuese si 'Meka' në mënyrë që të hapen sa më shumë vende të reja pune dhe sa më pak të rinj të detyrohen të largohen", ka thënë Veseli.

Kurse përfaqësuesi i kompanisë "Meka", Burim Piraj, ka thënë se ishte rast i mirë për ta



njoftuar Veselin për problemet me të cilat ballafaqohet kjo kompani. "E falënderojmë kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës,

njëherësh edhe kryetar i PDK-së, Kadri Veseli, dhe kryetarin e Komunitetit të Dragashit, Shaban Shabani, për vizitën që i bënë kompanisë. Ishte një rast

shumë i mirë për t'i njoftuar ata me problemet me të cilat ballafaqohemi çdo ditë, duke filluar nga mungesa e energjisë elektrike dhe e problemeve të

tjera që kanë prodhuesit vendorë. Vetëm të martën 20 herë kompjuteri më është fikur nga energjia elektrike, e cila është e dobët", ka thënë Piraj.

GAP-i thotë se ka ngecje në digjitalizimin e shërbimeve administrative

Agron Demi nga Instituti GAP ka prezantuar të gjeturat e raportit mbi problemin e reformimit të administratës publike, me theks të veçantë ngecjet në ofrimin e shërbimeve administrative në formë digjitale. Ai ka thënë se edhe në këtë mandat qeverisës, ashtu sikurse edhe në qeverisjet e kaluara, reformimi i administratës dhe digjitalizimi i shërbimeve nuk kanë qenë prioritet

duke marrë gjithnjë e më shumë buxhet të tak-sapaguesve, e rrjedhimisht duke mos lehtësuar marrjen e shërbimeve për qytetarët. Përkundër asaj se që nga shpallja e pavarësisë janë aprovuar dhjetëra dokumente strategjike e plane veprimi, shumë nga aktivitetet dhe objektivat e parapara kanë mbetur vetëm në letër. Çdo vit shpenzohen mesatarisht 10 milionë euro për pajisje dhe sisteme të teknologjisë së informacionit, por asnjëri nga sistemet e instaluar elektronike nuk është funksional plotësisht", ka thënë Demi.

Ai ka shtuar se qytetarët obligohen që për kryerjen e çfarëdo shërbimi të dorëzojnë një mori dokumentesh të cilat edhe ashtu janë në pronësi të institu-

cioneve publike. "Kësisoj, çdo vit lëshohen mbi dy milionë dokumente nga regjistri i gjendjes civile, qëllimi primar i të cilave është që të dorëzohen prapë tek institucionet për kryerjen e ndonjë shërbimi. Kjo ka bërë që administratat të jenë të mbingarkuara, kurse qytetarët obligohen që të enden nëpër institucione të ndryshme për marrjen e një shërbimi", është shprehur Demi.

Ndërkaq Bekim Salihu ka prezantuar të gjeturat e raportit mbi nivelin komunal. Sipas tij, komunat janë shumë të varura nga niveli qendror sa i përket racionalizimit dhe digjitalizimit të shërbimeve administrative. Megjithatë, ai ka thënë se komunat kanë ndërmarrë vetiniciativë për lehtësimin e shërbimeve administrative,

duke instaluar kioskë elektronike për nxjerrjen e dokumenteve. "Nga 38 komuna, 19 kanë instaluar kioskë elektronike. Por, nga hulumtimi në terren ka rezultuar se nga 42 kioskë elektronike që janë instaluar nëpër komuna, më shumë se gjysma e tyre janë jofunksionale. Arsyet më të shpeshta për mosfunksionimin e kioskave elektronikeve kanë të bëjnë me ndërprerjet e shpeshta të internetit, vendosja e tyre në vende të hapura e të pambrojtura nga kushtet atmosferike, mungesa e përkujdesjes dhe mosfurnizimi i tyre me rregull me material shpenzues. Këto pengesa, si dhe hezitimi i qytetarëve për t'u shërbyer nga to, kanë bërë që kioskat elektronike të mos e arrijnë qëllimin e synuar", ka deklaruar Salihu.

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 14 GUSHT - Instituti GAP ka prezantuar të gjeturat e raportit me titull "Ngecjet e komunave në funksionalizimin e shërbimeve administrative".

Agron Demi ka prezantuar të gjeturat e raportit mbi problemin e reformimit të administratës publike, me theks të

veçantë ngecjet në ofrimin e shërbimeve administrative në formë digjitale. Ai ka thënë se edhe në këtë mandat qeverisës, ashtu sikurse edhe në qeverisjet e kaluara, reformimi i administratës dhe digjitalizimi i shërbimeve nuk kanë qenë fare prioritet. "Përkundrazi, administrata publike në vazhdimësi po shkon duke u politizuar, duke degraduar profesionalisht,



Deputeti Aliu thotë se po degradohen lumenjtë

PRISHTINË, 14 GUSHT (ER) - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Liburn Aliu, ka paraqitur sërish problemet që janë duke vazhduar me degradimin e pellgjeve lumore në kurriz të banorëve dhe bilancit ujor. Aliu në një konferencë për medie të mërkurën ka thënë se me rënien e qeverisë është krijuar përshtypja e rrejshme e qetësisë nëpër institucione. Sipas tij, vëmendja

mediatike është drejtuar kah deklaratimet paraelektorale teksa disa mekanizma janë duke funksionuar me zell të madh në degradimin e ambientit, konkretisht lumenjtë. "Dje pata rastin të jem në vizitë në Shtërpcë, sërish në vizitë për punimet rreth hidrocentraleve që po ndërtohen atje, punë këto që qytetarët atje po i kundërshtojnë tash e sa kohë. Kundërshtimi i tyre i pandër-

prerë dhe i drejtë ka bërë që të rritet sensibilizimi edhe në shoqërinë civile", ka thënë Aliu. Ai ka thënë se për çështjen e hidrocentraleve të reja kudo në Kosovë deri më tani është protestuar dhe ka pasur edhe raportime në komisionet parlamentare. Aliu ka deklaruar se punimet në hidrocentrale janë duke u bërë me shkelje të shumta ligjore dhe pa ndonjë analizë ujore dhe mjedisore.



Jashari dhe Gashi inspektojnë punimet e palestrës sportive në Skenderaj

SKENDERAJ, 14 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me ministrin për Kulturë, Rini dhe Sport, Kujtim Gashi, të shoqëruar

edhe nga nënkryetari Nuredin Lushtaku, deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu, drejtoresha e Urbanizmit, Sanije Ahmeti dhe profesionistët e kësaj komune, kanë inspek-

tuar punimet për realizimin e projektit të palestrës sportive të Skenderajt.

Kryetari Jashari ka thënë se kompania e kontraktuar do ta rifillojë punën aty ku ka

mbetur, në mënyrë që ky projekt të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, për t'u vënë më pas në shërbim të klubeve tona sportive dhe të rinjve.



Komuna e Mitrovicës bën shpërndarjen e 116 koshereve me bletë

MITROVICË, 14 GUSHT (ER) - Komuna e Mitrovicës, përkatesisht Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka mbështetur 58 fermerë, të cilët kanë përfiturar 116 koshere me bletë, ku me këtë rast kanë përfiturar nga dy shoqëri të bletëve për secilin. Drejtori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ekrem Sadiku, ka uruar të gjithë fermerët përfitues, gjithashtu është shprehur i kënaqur me mbarëvajtjen e përzgjedhjes së këtyre fermerëve, duke theksuar se procesi është realizuar gjithmonë sipas procedurave të parapara dhe se pjesëmarrja ishte e kënaqshme me 25 për qind, duke pasur parasysh se të gjithë janë fermerë fillestarë. Ai ka thënë se ky projekt implementohet me qëllim të stimulimit të fermerëve dhe rritjes së aftësisë konkurruese në sektorin e bletarisë.

Drejtori Sadiku ka thënë se prioritet i tij gjatë udhëheqjes së Drejtorisë së Bujqësisë është realizimi i projekteve për zhvillimin e bujqësisë dhe lehtësimin e punës së fermerëve. "Ne do të vazhdojmë të punojmë së bashku që sektorin e bujqësisë ta zhvillojmë sa më shumë në komunën tonë. Komuna e Mitrovicës ka potencial të mjaftueshëm që sektori i bletarisë të zhvillohet dhe në këtë mënyrë ta ngrehim edhe cilësinë në tregun tonë", ka thënë Sadiku.

Vlera totale e këtij projekti është 12 975 euro e 76 centë. Ky është projekti i tretë me radhë për këtë vit kushtuar fermerëve të cilët merren me kultivimin e bletarisë, fillimisht ishte organizata e Caritasit në Kosovë, organizata IADK dhe Caritasi Zviceran, ku në të gjitha këto grante Komuna e Mitrovicës ishte participuese.



Policia sekuestron dy armë në pronësi ilegale në Prizren



PRIZREN, 14 GUSHT (ER) - Më 13 gusht rreth orës 13:45 është pranuar një informacion se në lagjen "Ortokoll" të Prizrenit është vërejtur një person me armë në brez. Policia sapo ka pranuar informacionin menjëherë ka dalë në vendin e ngjarjes dhe tek i dyshuari T. C., Sh/K, i lindur në vitin 1997, ka gjetur në posedim: pistoletë 'Zastava', nr. serik. T-741859, me një karikator, pistoletën 'EKOL TUNA', nr.

serik. ET-1291565, tre fishekë të kalibrit 6.35 mm, një shufër metalike dhe një thikë. "Hetuesit dhe Njësi i Krimteknikës kanë dalë në vendin e ngjarjes. Armët dhe gjësendet e tjera janë sekuestruar. Në lidhje me rastin është njoftuar prokurori kompetent në Prokurorinë Themelore në Prizren dhe hetimet janë duke vazhduar", është bërë me dije në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Haliti viziton punimet e disa projekteve infrastrukturore në fshatin Binçë

VITI, 14 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti, me bashkëpunëtorë ka vizituar të mërkurën fshatin Binçë për t'i parë nga afër disa projekte që janë realizuar dhe po realizohen në këtë fshat në të cilën kalon lumi "Morava e Binçës", ku gjendet edhe shëtitë e cili dita-ditës po shfrytëzohet nga shumë qytetarë për ecje. Me këtë rast, Haliti ka parë nga afër punimet që kanë përfunduar në asfaltimin e rrugës "Nënë Tereza" që lidh mes vete qytetin e Vitisë me

Binçën. Ky projekt është realizuar në kuadër të bashkëpunimit të Komunës së Vitisë me Ministrinë Infrastrukturore dhe është segmenti i parë i rrugës Viti-Kërbliqë-Kaçanik. Gjithashtu, ai ka parë nga afër punimet për ndërtimin e një ure në këtë fshat që lidh mes vete fshatrat Binçë, Kabash dhe Shushtë.

Kryetari Haliti është takuar edhe me banorë të këtij lokaliteti të cilët u shprehën falënderues për realizimin e projekteve të shumta në këtë lokalitet.



Nis ndërtimi i gjashtë shtëpive për komunitete në Shtime

SHTIME, 14 GUSHT 2019 (ER) - Në Komunën e Shtimes ka filluar ndërtimi i gjashtë shtëpive për komunitete që jetojnë në këtë komunë.

Lajmin e ka bërë me dije kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Rahman Kadrija. Ky projekt është duke u realizuar në bazë të mar-

rëveshjes të cilën e ka nënshkruar kryetari i Shtimes, Naim Ismajli, me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Fillimin e punimeve

e ka përshëndetur nënkryetari i kësaj komune, Rahman Jakupi dhe kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Rahman Kadrija.



Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (17)

ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



**Përgatiti: Selatin
NOVOSELLA**

Kontributi Juaj na solli Dritë. Falënderues ndaj teje do të mbesim për jetë e mot!

30 korrik 2018,
Ismail Sadik Maloku

Iu shprehim ngushëllime familjes Demaçi dhe gjithë atyre që e deshën Kolosin e kombit, Adem Demaçin! Lavdi, Baca, Adem!

30 korrik 2018,
Hasan Ramadani

Ngushëllimet më të sinqerta për Heroin tonë, Adem Demaçin!

30 korrik 2018,
Sherife Ramadani

Adem Demaçi, Disidenti i papërsëritshëm në fund të shekullit XX dhe në fillim të shek. XXI, në luftë për lirinë e fjalës, lirinë e popujve dhe lirinë kombëtare!
Fat që i takova kombit shqiptar, Bacë! Lum ne që jetuam në Epokën tënde, o Heroi dhe Nderi i Kombit! Përulemi para veprës suaj, deri në pambarim! Lavdi!

30 korrik 2018,
Ç. A. Bubavec, Malishevë

Baca, Adem Demaçi, pusho në paqe!

30 korrik 2018,
Sanije Bajqinovci

Baca Adem e nisi dhe e përfundoi me nder misionin e tij si njeri e si shqiptar!

30 korrik 2018,
Esad Dujaka

Ngushëllimet më të sinqerta familjes dhe të gjithë shokëve dhe miqve, të Bacës, Adem Demaçi!

30 korrik 2018,
Sejdi Hoxha, Ibrahim Imeri

Ngushëllime dhe nderime Heroit të Kombit, Bacës, Adem Demaçi! Me respekt familja e Shaban Mazrekut, Sopi!

30 korrik 2018,
Shaban Mazreku, Suharekë

Adem, Baca ynë, të nderon familja Krajova! Pushoni në paqe! Do

të jesh gjithmonë me ne, ashtu si keni qenë përherë!

30 korrik 2018,
Remzi Krajkova

Ngushëllime të sinqerta për Bacën Adem Demaçi! Ti ke qenë njeri i madh për popullin shqiptar! Lavdi për jetë e mot!

30 korrik 2018,
Shyhrete Elmazi

Baca Adem, krenaria e kombit. Bacë tek Ti gjetëm rrugën e lirisë! Adem Demaçi, njeriu që ndërroi historinë nga robëria në liri! Lavdi! I paharruar kujtimi për Ty, Bacë!

30 korrik 2018,
Latif Gashi

Nuk do të harrojmë kurrë! Të kujtojmë përherë, Baca Adem!

30 korrik 2018,
Azem Murturi

Do të kujtojmë për jetë e mot, Baca Adem Demaçi!

30 korrik 2018,
Halit Breca

Të pata udhëheqës, të pata mik dhe shoq! Lavdi Jetës Tënde dhe të qoftë i lehtë dheu i Kosovës!

30 korrik 2018,
Sylejman Ajeti

Baca Adem, Madhështor dhe i përjetshëm mbetesh në zemrat tona të popullit shqiptar! Lavdi!

30 korrik 2018,
Adem Hulaj

Lum na dhe mbarë kombi shqiptar që të patëm, Adem Demaçin!

30 korrik 2018,
Sh. Krasniqi

Përherë fliste me zjarr, për komb e atdhe të vetin, e zemrën ma kënaqte! Fliste si profet, patriot i madh i shekujve je dhe mbetesh, Bacë! Sa i vogël ndjehem dhe nuk po kam fuqi të shprehem. Emri i Tij është i madh, e zemrën e ka të bardhë! Çdo fjalë e Tij, zemrën ma ngrohë!

30 korrik 2018,
Ajet Bejta

Në emër të qytetarëve të Hanit të Elezit i shprehim ngushëllime familjes, bashkëveprimtarëve dhe mbarë kombit shqiptar, për vdekjen e Bacës, Adem Demaçi - simbolit të rezistencës kombëtare! I përjetshëm qoftë kujtimi për Bacën, Adem Demaçi!

30 korrik 2018,
Refki Suma, kryetar i Hanit të Elezit



Pusho në paqe, krenaria e jonë! Vepra Juaj, Bacë, do jetojë përherë!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Ishe dhe mbetesh Kolosi i Lirisë së Kosovës! Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës, të cilën e deshe aq shumë!

30 korrik 2018,
S. Morina, E. Begolli, B. Statovci, L. Badivuku, S. Simnica

Zekeria Berisha, imam në Xhaminë e vendlindjes së bacës Adem Demaçi, lus Zotin e Mëshirshëm që të mëshirojë - Bacën Adem dhe ta shpërblejë në botën tjetër! Kësaj lutjeje i bashkohet edhe mulla Ali Berisha.

30 korrik 2018,
Zekeria Berisha, Ali Berisha

Sot ndihem i mërziur aq shumë sa që nuk fola, në mënyrë që të përmbahem nga lotët, me rastin e ngushëllimit për bacën, Adem! Ai neve na dha forcë në kohët më të vështira! Ai sakrifikoi çdo gjë për lirinë tonë. Vepra e këtij Njeriu nuk vdes kurrë!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Bacë,
Më kujtohet dalja Juaj nga burgu dhe vizita e juaj në banesën time në Lubjanë, më kujtohen këshillat Tuaja, për rrugën që duhet të bëjmë drejt lirisë! Këto porosi vlejné për rininë tonë që

është e ardhmja jonë! Lavdi jetës dhe veprës suaj. I përjetshëm kujtimi për Ty!

30 korrik 2018,
Skënder Fazliu, Lubjanë

Ajo që bëtë Ju për vendin dhe kombin, askush, askush para Juve s'e ka bërë! Nga zemra iu fale-minderit!

30 korrik 2018,
Luan Nimani

Jam krenare që pata rastin ta njoh të Madhin - bacën, Adem Demaçin!
Lavdi për jetë e mot!

30 korrik 2018,
S. Xhema
Lamtumirë dëshmor lirie!! Të përulem për artin e flijimit për idetë!

30 korrik 2018,
H. Matoshi

Gjithmonë në zemrat tona e në mendjen tonë i madhi, Baca Adem. Të përulemi për të gjitha që bëre për ne!

30 korrik 2018,
Mejreme Bunjaku

Baca Adem, ishe udhëheqës për generatën tonë! Kujtimi për Ty, për veprën dhe idetë Tuaja do të na prijë në rrugën e ndritshme. U bëre gurthemel i historisë sonë të lavdishme!

30 korrik 2018,
Kom. i brigadës 136 "Rugova"
Salih Lajçi

Adem Demaçi ishte dhe mbetet

frymëzim për shumë gjenerata të ardhshme! Lavdi jetës dhe veprës së Bacës Adem! Prehu në paqe!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Prehu në paqe, atdhetari ynë i përjetshëm, Baca Adem!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Përherë ishe me ne shpresë lirie, që nuk fikej kurrë!

30 korrik 2018,
Avdi Lajçi

E përjetshme është do mbetet vepra juaj, që bëri histori!

30 korrik 2018,
R. Lajçi

Fjalët janë të pakta ta përshkruajnë jetën dhe veprën Tënde, të cilën ia kushtove Kombit Shqiptar! Veprat Tuaja do të jetojnë përgjithmonë! U prehsh në paqe, Baca Adem!

30 korrik 2018,
B. Z. Neziri

Çka të them për Bacën, që na mbajti gjallë, na bëri të fortë në qëndresën tonë, kundër pushtuesit serb? Baca edhe pse fizikisht s'është me ne, me ne do të jetë sa të jetojë kombi shqiptar!

30 korrik 2018,
Xhavit Bajkaraktari, Ragip Xhaka

Një Legjendë, një krenari, një udhërrëfim për ne, kurdoherë! Lavdi bacë!

30 korrik 2018,
Fahri Ajeti

Ishe dhe mbetesh frymëzim për të gjithë brezat e tashëm e të ardhshëm!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Lavdi e përjetshme, Ikonë e rezistencës tonë kombëtare! Lavdi!

30 korrik 2018,
Bedri Hoxha

I qoftë i lehtë dheu i Kosovës, të cilës ia kushtoi gjithë jetën dhe veprimtarinë e vet atdhetare, pa u ndalur asnjëherë, deri në vdekje!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)

ShBA-ja e shtyn vendosjen e tarifave ndaj mallrave të Kinës

WASHINGTON, 14 GUSHT - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) e kanë shtyrë vendosjen e tarifave për disa importe nga Kina deri më 15 dhjetor për shkak të "sigurisë kombëtare dhe

faktorëve të tjerë". Prodhimet përfshijnë telefona celularë, laptopë, disa lodra, monitorë kompjuterësh, këpucë dhe veshmbathje. Lajmi befasesh nga Zyra e Përfaqësuesit e

Tregtisë së Shteteve të Bashkuara ngjallën një rritje prej 5 përqindësh të aksioneve të kompanisë amerikane Apple. Presidenti amerikan Donald Trump ka thënë se më 1 gusht

se do të vendosë një tarifë prej 10 përqindësh në 300 miliardë dollarë të mallrave kineze, duke fajësuar Kinën që nuk i zbatoi premtimet për të blerë më shumë produkte bujqësore amerikane.



Në Londër vazhdojnë përplasjet politike për procesin e Brexitit



LONDËR, 14 GUSHT - Ish-ministri i Financave i Britanisë së Madhe, Philip Hammond, ka akuzuar kryeministrin Boris Johnson se po përpiqet ta shkatërrojë mundësinë e një marrëveshje të re të Brexitit, duke bërë kërkesa që BE-ja kurrë nuk mund t'i pranonte. Në një artikull të "Times", Hammond ka thënë se një dalje e Britanisë nga BE-ja pa marrëveshje do të ishte "një tradhti" e rezultatit të referendumit 2016. Ai ka thënë se kjo "nuk duhet të ndodhë". Një burim nga qeveria ka thënë se Britania e Madhe do të largohet më 31 tetor përkundër "përpjekjeve më të mira të ish-ministrit

Hammond për të kundërtën". Burimi ka shtuar se ish-ministri "bëri gjithçka që mundi" për t'i bllokuar përgatitjet për largim dhe kishte 'minuar negociatat'. Por, Hammond i hodhi poshtë këto pretendime. Marrëveshja e negociuar me BE-në nga ana e ish-kryeministres Theresa May u rrëzua tri herë nga parlamenti britanik. May më pas dha dorëheqje dhe u pasua nga Boris Johnson. Ai ka thënë se do ta largojë Britaninë e Madhe edhe nëse nuk arrin një marrëveshje të re me BE-në. Zyrtarët e Bashkimit Evropianë deri më tani kanë kundërshtuar ta rinegociojnë marrëveshjen.

Rriten nivelet e rrezatimit në veri të Rosisë

MOSKË, 14 GUSHT - "Nivelet e rrezatimit afër zonës ku ka ndodhur një shpërthim raketor në veri të Rosisë janë rritur 16 herë më shumë sesa shifrat normale", ka thënë shërbimi i motit në këtë shtet. Rosgidromet ka matur nivelet e rrezatimit në qytetin Severodvinsk, pas shpërthimit që ka ndodhur në një zonë ushtarake në fshatin Nyonoksa të enjten e javës së kaluar. Agjencia shtetërore për çështje bërthamore e Rosisë, Rosatom, ka thënë se pajisja me fuqi

bërthamore ka qenë duke u testuar. Pesë nga shkencëtarët që kanë qenë pjesë e këtij procesi të testimit kanë vdekur dhe tre të tjerë janë plagosur në aksident, ka thënë agjencia. Instituti meteorologjik ka thënë se testimet në gjashtë stacione në Severodvinsk, qytet me 180 000 banorë, kanë treguar shifra nga 4 deri në 16 herë më të rritura sesa shkalla normale. Autoritetet e këtij qyteti kanë thënë se nivelet e rrezatimit

janë rritur pak pas shpërthimit, mirëpo i janë kthyer normalitetit 40 minuta më vonë. Rosgidromet në anën tjetër ka thënë se vlerat kanë qenë të rritur për dy orë e gjysmë. Shpërthimi ka alarmuar banorët afër kësaj zone, të cilët kanë blerë sasi të mëdha të jodit, që kufizon efektet e rrezatimit. Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, nuk ka dhënë detaje të martën për këtë testim dhe vetëm ka thënë se "aksidentet, fatkeqësisht, ndodhin".



OBSH-ja: Po rritet numri i rasteve të fruthit



GJENEVË, 14 GUSHT - Fruthi po përhapet në mbarë botën, po veçanërisht e prekur është Afrika. Por edhe në Evropë përhapja e kësaj sëmundjeje po jep shkas për shqetësim, ndaj Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) përballë kësaj gjendje kërkon më shumë vaksinime. Në gjysmën e parë të vitit 2019 në nivel global është regjistruar

numri më i madh i të prekurve nga fruthi në të njëjtën periudhë krahasuar me vitin 2006. Deri në fund të korrikut janë regjistruar në 182 vende, sipas shifrave paraprake, gati 365 000 raste fruthi. "Kjo shifër flet për tri herë më shumë të prekur sesa në të njëjtën periudhë të vitit 2018 dhe më shumë se përgjatë gjithë vitit të kaluar. Ata që udhëtojnë duhet të tregojnë kujdes dhe të verifiko-

jnë nëse vaksinimi i tyre është i efektshëm", ka njoftuar Organizata Botërore e Shëndetësisë me seli në Gjenevë. Nga mosha gjashtë muajsh, të gjithë duhet të vaksinohen të paktën 15 ditë përpara se të udhëtojnë në një nga rajonet e prekura. Vlerësimet aktuale për përhapjen e kësaj sëmundjeje u referohen të dhënave nga viti 2017.

Rifillojnë fluturimet në Aeroportin e Hong Kongut

Hong Kong, 14 gusht - Në Aeroportin e Hong Kongut kanë rifilluar fluturimet, pas një nate kaosi ku protestuesit pro demokracisë u përleshën me policinë. Fluturimet po zhvillohen siç ishte planifikuar, megjithëse disa ende mbetën të vonuara ose anuluar. Qindra fluturime u anuluan dy

ditët e kaluara pasi protestuesit zaptuan objektin. Më 13 gusht shpërthimi i dhunës në aeroport, një nga më të ngarkuarit në botë, përfshiu protestuesit që rrahën dy burra për të cilët dyshohet se ishin agjentë të fshehtë kinezë. Qeveria kineze dhe Hong Kongu dënuan "aktet pothuajse

terroriste" të demonstruesve dhe përsëritën mbështetjen për autoritetet lokale, për të ndëshkuar ashpër ata që janë përgjegjës. Hong Kongu ka hyrë në javën e dhjetë të protestave antiqeveritare të nxitura nga një projektligj që do të lejonte që të dyshuarit të përballen me gjyq

në Kinë. Projektligji u pezullua përfundimisht, por kërkesat e protestuesve janë rritur duke përfshirë dorëheqjen e udhëheqëses së Hong Kongut, Carrie Lam, zgjedhje të drejtpërdrejta, shpërbërjen e legjislaturës aktuale dhe një hetim mbi brutalitetin e dyshuar të policisë.



Hong Kongu është pjesë e Kinës, por gëzon më shumë autonomi sesa rajonet e tjera kineze.

Të gjithë i fitojnë zgjedhjet, vetëm një parti apo koalicion do të jetë fitues!



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

Kush do të jetë i dyti sepse i pari dihet: Një mik imi më tha se më është lagur baroti dhe se nuk po më dëgjohet zëri në këto çaste historike (si të gjitha ngjarjet e tjera në Kosovë) dhe se po më mungon guximi për t'i parashikuar rezultatet e zgjedhjeve eventuale të parakohshme që pritet të mbahen në tetor të vitit 2019. Realisht, edhe më herët pata thënë se zgjedhjet e parakohshme mund të mbahen në muajin nëntor të këtij viti, por disa zhvillime të paparashikuara e shpejtuan këtë proces që ka filluar të bëhet i mërzitshëm për faktin se zgjedhjet nuk po janë zgjidhje dhe nuk po sjellin cilësi të dëshiruar të qeverisjes. Të mbajnë njëfarë rendi:

Gjykata Speciale si katalizator i zgjedhjeve të parakohshme: Opozita e Kosovës, e fuqishme në numra, por impotente në veprime, LDK-ja dhe LV-ja, që nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve të fundit e ka pasur vetëm një kërkesë: organizimin e zgjedhjeve të reja. Tërë kohën e ka bllokuar punën e Kuvendit të Kosovës me seanca të jashtëzakonshme duke i dhunuar seancat e rregullta. Tehu i luftës për pushtet ishte drejtuar kundër kryeministrit të Kosovës, z. Ramush Haradinaj, kurse PDK-në e konsiderojnë më armiqësore se të gjitha ish-pushtetet e Mbretërisë serbo-kroato-slllovene, Jugosllavisë së AVNOJ-it, asaj të Zhablakut, Serbisë së Millosheviqit, Ilija Garashaninit, Nikolla Pashiqit, Drazh Mihajlit, Aleksandar Rankoviqit dhe Slobodan Millosheviqit, kurse Josip Broz Titon nuk e fus në këtë mes sepse jo pak politikanë të opozitës në Kosovë janë spermatozoidë politikë të Titos. Thuaja ishin afër sigurimit të nënshkrimeve për mocion për rrëzimin e qeverisë Haradinaj. Në këtë kontekst i luteshin Gjykatës Speciale që sa më shpejt të arrestojë kundërshtarë politikë e që ishin në pozitë, në mesin e të cilëve e pranoj se ka keqbes të mëdhenj, hajdutë të shndërruar në milionerë si pasojë se u bënë dirigjentë të kriminit të organizuar dhe të tjerë, të hirit

dhe të konopit, me të cilët ishin të gatshëm të bashkëpunonin më parë për marrje të pushtetit. Dëshira e tyre shkoj në vesh të Zotit (Gjykatës Speciale) e cila e thirri, në cilësinë e të dyshuarit për intervistim, kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, i cili duket të jetë i parapaguar te të gjitha gjykatat për krime lufte, si klient i pashmangshëm, që nga Tribunali i Hagës, gjykatat hibride të UNMIK-ut (e përbërë nga gjykatës ndërkombëtare dhe atyre të Serbisë), gjykatat e EULESH-it, që e bënë punën, jo lesh, por krejt m.t. nga gjykatat e Serbisë dhe, më e reja, nga Gjykata Speciale. Ramush Haradinaj e bëri një veprim të admirueshëm shtetëror dhe moral duke dhënë menjëherë dorëheqje nga posti i kryeministrit dhe duke shkuar në Hagë si person apo individ privat në mënyrë që Kosovën mos ta ngatërrojë në këtë prostitucion të drejtësisë. Tash reagimet ishin se Ramushi dezertoj dhe se nuk ka pasur nevojë të dorëhiqet sepse këtë nuk e bëri askush deri më tani. Ta shohim anën tjetër: po të kishte shkuar Ramushi në Hagë si kryeministër i Kosovës, do të sulmohej nga po këta partizanë kujdestarë se, vetëm për ta ruajtur pushtetin, nuk ka pranuar të dorëhiqet nga posti dhe në këtë mënyrë po e ngatërrojnë edhe shtetin e Kosovës përmes postit më të lartë ekzekutiv, në krime të luftës. Tash po thonë se Ramushi nga kjo dorëheqje dëshiron të përfitojë politikisht! E pse të mos të ketë të drejtë të përfitojë politikisht kur ka investuar aq shumë (dorëheqja nga posti), ndërsa të tjerët, pa e bërë edhe investimin më të vogël në shërbim të vendit dhe popullit, duan ta marrin pushtetin e që është edhe më keq, angazhimin e tyre të mëparshëm kundër popullit dhe vendit, duan ta materializojnë me marrje të pushtetit. Historia e Kosovës dhe shqiptarëve nuk ka filluar në vitin 1989, por shumë më herët. Nëse asgjë nuk ka bërë gjatë këtij mandati të përgjysmuar të Ramush Haradinajt, vendosja e taksës 100 % për mallra nga Serbia e Vuçiqit dhe Bosnja e Dodigut, ia lanë të gjitha të tjerat sepse ka penguar ndarjen e Kosovës. Realisht, i biri i Fahriut dhe Shimi patën prerë rroba për nënshkrim të marrëveshjes "historike" dhe detyruese në Garden Roses, në oborrin e marrë me qira nga Trampi për katër vjet sikur që mendonin se ku do t'i shpenzonin paratë nga Çmimi Nobel për Paqe e që e llogarisnin si punë të kryer. Përsëri Shimi dhe Ujku, me

nënë Rea Mogerini. Këto matematika ua prishi Ramushi me një ekuacion të thjeshtë dhe pa një asnjë të panjohur; nuk ka marrëveshje që rrezikon tërësinë territoriale të Kosovës. Disa veprime që merren në kohë të duhur dhe që bartin shumë rreze, e vulosin historinë dhe ardhmërinë. Taksa 100 për qind e Ramush Haradinajt është dhe do të mbetet vulë e përjetshme e përpjekjeve për kthim të krenarisë shtetërore dhe kombëtare. Pashmangshëm se ky veprim i siguron rritje të votave për Ramushin dhe partinë që e drejton. Ramushi e ka luajtur potezin e duhur, në kohën e duhur që do të duhej të bënte çdo politikan që është pjesë e garës politike! Dikush po e përdorë bashkimin kombëtar për qëllime politike, dikush po ia bashkon Tërrnovcin e Madh, me 35 xhami Kosovës, gjithashtu për qëllime politike. Të tjerët po kërkojnë vota nga Varri, kurse disa të tjerë gjithashtu po kërkojnë vota nga varri ku është varrosur "Heroi i Kosovës", Pablo Eskobari. Dikush po kërkon vota nga dezertorët apo nga ata që e luftuan UÇK-në përmes një formacioni që bënte shtatë palë qejfe larg fronteve të luftës, kurse të tjerët presin vota nga një maskarallëk siç janë veteranët e rrejshëm. Po e shihni që votat po kërkojnë nga ata, që në situata normale dhe në një vend normal, edhe po të votojnë për juve, nuk duhet t'i pranoni ato vota por, në kohën e ndryshkut moral dhe antivlerave, askush nuk po kërkon vota duke u thirrur në dy abetaret e lirisë dhe pavarësisë si dhe bashkimin kombëtar; të papërsëritshmit Bacë Adem Demaçi dhe legjendarit Adem Jashari.

Të gjithë kryeministria, të gjithë të parët, asnjëri ministër apo i dyti: LDK-ja po thotë se i fiton zgjedhjet e që ashtu thonë edhe LV-ja, PDK-ja, AAK-ja, Nisma, AKR-ja, Alternativa për Gjakovën, Lëshmi Euroatlantik dhe fatosët dhe pioneret e Kaçusha Jasharit. Nëse më pyetni se kush do të jetë fitues i zgjedhjeve, përgjigjen e keni të sigurt: të gjitha partitë që do të garojnë. Nëse më pyesni se cili do të jetë subjekti i dytë në këtë zgjedhje do të më zëni ngushtë sepse nuk do të keni përgjigje. LDK-ja si fituese e zgjedhjeve nuk e lëshon postin e kryeministrit me asnjë çmim. Edhe më parë thoshte kështu në kohën kur kryeministrin e merrnin si dhuratë të Trojës për gatishmëri për bashkëpunim për "interes të shtetit dhe marrje të pushtetit".

LV-ja, edhe po të ishin gjallë Hasan Prishtina, Ahmet Zogu, Ismail Qemali, Mehmet Shehu, por edhe pse janë gjallë Edi Rama dhe Fatos Nano, postin e kryeministrit e ka vetëm për Albin Kurtin e që, për shkak të rrethanave aktuale politike vendore dhe ndërkombëtare, paraqet sfidë sa edhe restaurimi i Trojës të cilën ende nuk e zbuluan. PDK-ja nuk ka më objekte për të lëshuar me qira, prandaj kryeministrin e ka rezervuar për Kadri Veselin. Bëhet, pse jo. Edhe unë mund të bëhem Ajatollah i Iranit, Behxhet Shab el Bajgora. Ramushin nuk ka bir apo bijë nënë në AAK që ka guxim t'ia tregojë se e do postin e kryeministrit, qoftë edhe në ëndërr. Këta të Nismës po thonë se nuk e dini se çka do të thotë posti i kryeministrit pa u bërë Fatmir Limaj kryeministër. Behgjet Pacolli e ka përkrahjen e plotë dhe të pakundërshtueshme të të anëtarësisë së AKR-së (tre anëtarë) për kryeministër. Aleanca për Kosovën, alias Aleanca për Gjakovën, është në pozitën më të mirë dhe më të favorshme; nga gjithsej dy anëtarë që i ka, Ilir Dedja dhe Mimoza Kusari, që të dy janë kandidatë seriozë për kryeministër të Kosovës! Shpendkeqi nga PSD-ja, po i var shpresat, tope... në një qeveri politeknike. Vetëm në atë mënyrë i arrin majat. Në atë mënyrë edhe Albini e pati promovuar, nga rrethi i tetë i FER-it, në parajsë të LV-së. Për mua mbetet i panjohur fakti e që mund të jetë vendimtar në planin global dhe kombëtar nëse Danush Ademi është kandiduar për kryeministër të Kosovës. Nëse Danushi, me tërë bagazhin politik dhe profesional që e ka, kandidohet për kryeministër, këta të tjerët mund dhe do t'i bien fyellit e disa edhe kavallit. Me Albinin kryeministër ka gjasë që disa t'i bien pianos në Kollegium Kantorum në Dubravë apo BSL në Gërdoc.

Të gjithë për zgjedhje, askush nuk i do zgjedhjet: Të gjithë u entuziazmuar për këto zgjedhje të parakohshme. LDK-ja llogarit se 100 për qind do të jetë fituese. Edhe mund të jetë. Jo pse ka punuar mirë, por se të tjerët kanë punuar keq. LDK-ja nuk është as parti unike e më së paku vendimmarrëse. LDK-ja në Kuvendin e fundit është përçarë brenda, kurse ambalazhimin e jashtëm e ka si të ishte krejtësisht e bashkuar. Në Kuvendin e fundit të LDK-së u integrua edhe pjesa e kriminit të organizuar për çka i akuzonte subjektet e tjera politike. Tash

LDK-ja është e ngjashme me partitë e tjera. LDK-ja nuk arriti ta nxjerrë një udhëheqje vendimmarrëse dhe vepruese, por se po e mban udhëheqjen me viagra dhe stimulues të tjerë politikë, me afat të skaduar.

LV-ja po thotë se do t'i fitojë zgjedhjet dhe se për këtë nuk e ka asnjë dyshim. Po të ishte e pandarë edhe mund t'i fitonte zgjedhjet, kështu e ndarë dhe e udhëhequr nga Akademia e Pleqve të Mençur të LPK-së, e ka vështirë t'i fitojë zgjedhjet, prandaj po shtrihet në shtratin e LDK-së, për kursin e Kasutras politike. Me LDK-në e kanë një joshje sistematike, tundim të çastit për formim të koalicionit, por kjo dashuri midis dy partnerëve - që kurrë nuk janë dashur - ka mungesë të theksuar pasioni. Nuk ka fare pasion. Nuk funksionon fare kimia midis LV-së dhe LDK-së përveç gazit lotsjellës.

PDK-ja pati rënë fort dhe u gjet në situatë që askush nuk e do, madje as edhe për një përdorim të vetëm. Prandaj është detyruar të shkojë e vetme në zgjedhje e që besoj se do të jetë më e mirë për këndellje politike apo të marrë dëshminë për vdekje definitive, si subjekt politik. Për faktin se PDK-ja po insiston në zgjedhje të parakohshme tregon se e ka një siguri ndryshe, me të gjitha mjetet e lejuara (Hashim Thaçin) dhe të gjitha mjetet e palejuara (Hashim Thaçin) do t'i pengonte zgjedhjet e parakohshme. Dhe sigurisht se do t'ia dilte t'i pengojë këto zgjedhje.

AAK-ja nuk besoj se do të fitojë në këto zgjedhje, por jam i sigurt se do të fluturojë shumë lart, më lart se çdoherë tjetër. Jam i sigurt se do të kemi shpërndarje të madhe të votave dhe se dallimi midis të parit dhe të parit (nuk ka parti të dytë) do të jetë e ngushtë. Koalicionet parazgjedhore të subjekteve të mëdha do ta dhunojnë demokracinë, koalicionet e partive të vogla i japin sharmë demokracisë. Askujt nuk do t'i dalin llogaritë ashtu si u thotë kalkulatori i tyre, do të ketë shumë zhgënjime. Por, diçka jam i sigurt: kushdo që fiton në këto zgjedhje, ndryshimet dhe përpimet do të jenë të papërfillshme. Personalisht do ta përkrah çdo qeveri, çdo parti, çdo koalicion që do të vendosë rend dhe rregull edhe nëse nuk pajtohem me ata. Të shohim më vonë si do të zhvillohen ngjarjet e pastaj vazhdojmë. Me këtë ia dëshmovam mikut tim se nuk kam mungesë guximi, se jam trim ndonëse thuhet, me të drejtë, se nuk ka trima të mençur, por vetëm trim budalla!

E rrallë

Roboti i frikshëm rus që javën e ardhshme do të niset për një mision në hapësirë

Agjencia hapësinore ruse ka treguar robotin android me aftësi të mahnitshme antropomorfe që do të jetë pjesë e një misioni në Qendrën Ndërkombëtare të Hapësirës dhe niset gjatë



javës së ardhshme. Fedor është quajtur ky robot i frikshëm rus, që është testuar në Qendrën Baitkon Cosmodrone të Kazakistanit, për kapacitetin e baterisë dhe mundësitë e lëvizjes.

FOTO E DITES



Vendësit në Bagdad të Irakut shihen duke lozur në një park lojërash. Fotografia: Xinhua. /Barcroft Media.

E jashtëzakonshme

Donte ta shiste videolojën e vjetër tek dyqani i pengjeve, zbulon një thesar 13 mijë dollarësh

Duke gërmuar nëpër rraqet e shtëpisë mund të gjejmë objekte që me kalimin e kohës kanë fituar një vlerë të madhe, krahasuar me çmimin me të cilin janë blerë, duke bërë që pronari me fat të fitojë një pasuri të tërë. Kjo i ndodhi një burri në Seattle, Uashington, ShBA, i cili ka vajtur te dyqani i



13 mijë dollarësh.

pengjeve, i specializuar për shitblerje të videolojërave të vjetra. Ai donte ta këmbente lojën e parë dhe historike "Nintendo". Ajo që burri nuk dinte, ishte se mes dhjetëra lojërave pa ndonjë vlerë, ishte fshehur edhe një diskete shumë e rrallë, me vlerë

BARSOLETA E DITËS



Dy shokët:
- Njeri, po dua t'ia bëj një dhuratë femrës sime, por s'po di çka.
- Qysh duket me pa?
- Shumë e fortë, shumë e bukur, e gjatë dy metra, trupin peshk.
- Jepja numrin tim.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30 "Spider-Man Far From Home" 3D,

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min
Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts



Çdo ditë në ora 17:30 "THE LION KING" 3D

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

Rolet: Donald Glover, Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyoncé Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver
Regjia: Jon Favreau



Në ora 19:30 dhe 22:00

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
Regjia: David Leitch




Nga dt. 08.08.2019

"THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"

Horror/Triller; 1 orë 39 min

Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

Regjia: Thurop Van Orman



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.

 <p>DASHI Nëse nuk jeni shumë i bindur për ç'ka do të realizoni vetë mund të kërkonti ndihmë tek persona që dini që ju ndihmojnë pa rezerva.</p>	 <p>DEMI Jeni prekur nga përshtypjet jo të mira të dikujt rreth jush. Nuk ka ardhur t'ua thotë përballë, por po i mësoni nga persona të tjerë.</p>	 <p>BINJAKËT Nuk e dini se sa mundësi konkrete keni për të realizuar një impenjim të ri. Do të filloni të matni mundësitë e suksesit në fund të projektit.</p>	 <p>GAFORRJA Edhe pse financat janë të rëndësishme për ju, për momentin keni më shumë pretendime në çështjet morale sesa ato financiare.</p>	 <p>LUANI Nuk do të keni shumë mundësi të shprehni aftësitë tuaja sot. Edhe në ato raste që do të mundoheni, të tjerët do të marrin meritat në vendin tuaj.</p>	 <p>VIRGJERESHA Sot do të keni mundësi të rikuperoni mungesat e mëdha në familje. Marrëdhënia juaj është e bazuar mbi besimin dhe sot do ta justifikoni.</p>
 <p>PESHORJA Jeni të lirë të bëni zgjedhjet tuaja në fushën sentimentale, por do të ndikoheni shumë edhe nga ambienti që ju rrethon.</p>	 <p>AKREPI Po shikoni mendimet pro dhe kundër lidhur me një situatë të caktuar për të vlerësuar në mënyrë sa më korrekte personat e përfshirë.</p>	 <p>SHIGJETARI Jeni realistë dhe e keni kuptuar mjaft mirë që një marrëdhënie e caktuar nuk po funksionon. Do të tërhiqeni pa lënduar askënd.</p>	 <p>BRICJAPI Po silleni shumë qartë dhe hapur me një person të caktuar sepse nuk doni të lini vend për keqkuptime. Në të kaluarën keni rënë pre e llafeve të kota.</p>	 <p>UJORI I keni dhënë mesazhe të qarta personave që nuk mendojnë njësoj si ju. Jeni tepër krenarë për të kthyer rrugën që keni nisur.</p>	 <p>PESHQIT Dita do të nisë me një përsëritje, mbase dikush që do të niset në një udhëtim ose ju që keni një udhëtim pune.</p>

Once Upon a Time in Hollywood arrin 100 milionë dollarë në arkën filmike në ShBA



Filmi i fundit i Quentin Tarantino 'Once Upon a Time in Hollywood' është vetëm filmi i dytë original i vitit 2019 që ka arritur 100 milionë dollarë në arkën e ShBA-së. Filmi i publikuar së fundmi është kryesisht fiktiv,


megjithëse ndërthuret me njerëz të vërtetë në histori dhe përdor vrasjet e Charles Manson si sfond. Filmi horror i Jordan Peel 'Us' është filmi i vetëm original deri më tani këtë vit që ka bërë më shumë se 100 milionë dollarë.

Gigi Hadid dhe Tyler Cameron e dëshmojnë se romanca e tyre po lulëzon



Tyler Cameron dhe Gigi Hadid po dëshmojnë se romanca e tyre po lulëzon. Në disa fotografi të publikuara nga mediami "E!" çifti shihet duke dalë nga apartamenti i tyre veçmas në NYC të hënën në mbrëmje. Të dy të famshmit dolën me veshje të

rastësishme derisa u kapën nga fotografët. Në të vërtetë, modelet që u takuan për herë të parë në "Instagram" nuk kanë qenë të turpshëm për lidhjen e tyre. Javën e kaluar ata ishin në Brooklyn përpara se të përfundonin përsëri në banesën e Gigit.



Beyoncé shijon pushimet me binjakët e saj

Beyoncé është një nënë e 'marrosur' pas tre fëmijëve të saj, por në media më shpesh është parë me vajzën e saj të madhe Blue Ivy. Ndërkaq, binjakët e saj janë mbajtur jashtë vëmendjes së publikut. Gjatë fundjavës,

këngëtarja e Lemonade u pa në një foto me Rumin dhe Carter, si dhe burrin e saj Jay-Z gjatë një pikniku familjar në Hamptons. Fotografitë e publikuara në "Daily Mail" tregojnë dy prindërit duke i mbajtur në krahë më të vegjlit e familjes.

Djali i Angelinës mbush 18 vjet, por feston ndryshe ditëlindjen



Djali i madh i Angelina Joliet, Maddox, sapo ka mbushur 18 vjeç. Por, ndryshe nga festat e çmendura që bëjnë fëmijët e të famshmëve, Maddox dhe nëna e tij vendosen

të bëjnë një shëtitje te të njohurit e tyre. Nënë e bir shkuan ta vizitonin mikun e familjes dhe autorin e "First They Killed My Father", Loung Ung, në Ohio dhe shijuan një drekë të rastit.



MODELET E MAKINAVE QË 'JETUAN' MË SHUMË SESA E MENDUAN KOMPANITË E PRODHIMIT

Në kohët e sotme, kompanitë e makinave duket sikur prezantojnë modele të reja vit pas viti. Larmia e versioneve, dizenjove e modeleve është aq e madhe sa as dashamirësit më të mëdhenj të makinave nuk i ndjekin dot.

Prodhimi mesatar për një model të ri është rreth 6 vite. Kjo do të thotë që kur një kompani sjell një model të ri, teksa e shesin, janë duke planifikuar modelin pasardhës.

Megjithatë, industria e makinave është plot me modele specifike që janë prodhuar për shumë vite, më shumë se ç'prisnin vetë kompanitë.

KËTO JANË DISA PREJ TYRE

Mercedes SLR107 u prezantua në vitin 1971 dhe u kthye në simbol të klasit të lartë të makinave kabriole. Prodhimi i këtij modeli

vazhdoi për plot 18 vite, dhe u ndërpre vetëm në vitin 1989.

Fiat Panda u prodhua për herë të parë në vitin 1980, dhe vazhdoi deri në 2003. Edhe pse të vogla, "Panda" kishte hapësirë, çmim të leverdisshëm dhe mirëmbahej lehtë.

Range Rover - Modelet moderne luksoze të "Range Rover" janë shumë të përhapura sot, por zanafillën e ka në vitin 1970. Ishte makina e parë që mund të përdorej jashtë rrugë e që njëkohësisht ofronte rehati, dizenjo të bukur dhe paraqitje të këndshme edhe mbi asfalt. Prodhimi i këtij modeli specifik vazhdoi deri në vitin 1996, për plot 26 vite.

Jeep Wagoneer/Grand Wagoneer, e paraqitur në vitet '60, ishte modeli i parë luksoz jashtë rrugë. Ishte i përkryer për shkretëtira e për autostrada. Ka qenë në treg pa u ndryshuar nga viti 1963 e deri në vitin 1991, për plot 28 vite.

Volkswagen Jetta MK2. Kur Volkswagen paraqiti modelin popullor "Golf", "Jetta", në vitin 1983, ishte versioni me të njëjtin motor, por me trup më të gjatë (Sedan). Edhe pse prodhimi në Europë ndaloi në vitin 1991, në Kinë vazhdoi të prodhohet deri

në vitin 2013, kur u ndërpre për herë të parë pas 29 vitesh.

Toyota Century ishte një limuzinë tepër zyrtare, e dizenuar fillimisht për familjen mbretërore të Japonisë dhe më pas u përdor gjerësisht nga anëtarët e mafias japoneze, Jakuzi. Toyota Century u hodh në treg në vitin 1967 dhe vazhdoi të prodhohet për 30 vite, me ndryshime tepër minimale.

Peugeot 404. Modeli që e bëri "Peugeot" popullor deri në SHBA ishte "Peugeot 404". U prezantua në vitin 1960, me motor 1.5 benzinë dhe 1.9 naftë, dhe vazhdoi të shitet për 31 vite. Ajo që e bëri shumë tërheqëse në fillim ishte dizenoja elegante, e skarën e kromuar dhe fletët e ngritura në pjesën e pasme.

Land Rover Defender. Land Rover-i i parë u prezantua në vitin 1948, dhe për gjithë këto vite ka qenë makina ideale për udhëtime jashtë rrugë. Modeli ka qenë aq popullor sa e ka vazhduar prodhimin deri në vitin 2016, për 33 vite.

Lada Riva e vitit 1980 ishte një kopje e Fiat 124 Sedan. Makina ruse ndryshoi vetëm emrin më pas, por ruajti formën dhe dizen-





jon, dhe vazhdoi të prodhohet deri në vitin 2012 për plot 32 vite.

Toyota Land Cruiser u paraqit në vitin 1984 dhe vazhdon të prodhohet edhe sot. Modeli specifik Land Cruiser 70 ka vazhduar të prodhohet po njësoj për 35 vite. Megjithatë, Toyota i ka vendosur disa detaje moderne për ta përshatur me standardet e sotme.



Volkswagen Golf Mk1, apo siç njihet thjesht "Golf 1", ka qenë një makinë me ndikim të stërmadh në popullsi dhe në industri. Bëri shumë bujë kur u paraqit fillimisht në vitin 1974, por nuk priste njeri që ta vazhdonte prodhimin për 35 vite. Edhe pse ky model ndaloi së prodhuari në Europë që në vitin 1983, në Afrikën e Jugut vazhdoi deri në vitin 2009.



Mercedes G-Class. Ky model i tipit ushtarak, për përdorim jashtë rrugë, u paraqit nga Mercedesi që në vitin 1979. Për shumë vite u është shitur agjencive policore si dhe ushtrive në të gjithë botën, dhe pothuajse nuk ndryshoi fare si model. G-Class u zëvendësua më në fund në vitin 2017 me një model që në fakt është pothuajse identik me të parin, me pak ndryshime, duke qëndruar në treg për 38 vite.



pothuajse të njëjtin konstrukt si Mini. Modeli original vazhdoi të prodhohej deri në vitin 2000, për plot 41 vite.



Mini Morris u paraqit në vitin 1959 si një model i pazakontë, me rrotat e përparme aktive, gjë që e bënte revolucionare për kohën. Sot, pas 60 vitesh, makinat me rrotat e përparme aktive kanë

Volkswagen Beetle e ka nisur prodhimin në vitin 1938, dhe si model është ndërprerë vetëm në vitin 2003. Gjatë kësaj kohe ka shitur më shumë se 22 milionë makina në të gjithë botën. "Beetle" ishte makina e parë që mori famë botërore për sa i përket çmimit të përballueshëm dhe paraqitjes së këndshme. Beetle ka qenë në prodhim për 65 vite.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Shabani: Drita do të luftojë për titull dhe Kupë

Bujar Shabani ka thënë për "Epokën e re" se Drita në edicionin e ri do të luftojë për trofe në elitën e futbollit të Kosovës dhe më pas do ta prezantojë Kosovën në garat ndërkombëtare. Mesfushori i skuadrës nga Gjilani ka lavdëruar edhe përforsimet e bëra në këtë afat kalimtar



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 GUSHT - Mesfushori Bujar Shabani është optimist se skuadra e Dritës në edicionin e ri futbollistik 2019/2020 do të jetë e suksesshme. Shabani të mërkurën për "Epokën e re" ka thënë se klubi ka krijuar kushte shumë të mira për futbollistë dhe kjo duhet të shpërblehet me trofe. "Klubi ka krijuar kushte të mira për punë dhe do të mundohemi sivjet në maksimum që të fitojmë trofe në mënyrë që të shpërblejmë atë që po bën klubi për ne", ka thënë Shabani. Mesfushori Shabani është i kënaqur me performancën e skuadrës nga Gjilani në ndeshjet përgatitore dhe beson se kjo skuadër do të luajë sërish në Evropë. "Kemi bërë një fazë përgatitore të mirë dhe kemi luajtur miqësore të

forta dhe e mira është se futbollistët e ardhur janë ambientuar shumë mirë. Kjo na bënë të mendojmë dhe besojmë shumë se do të fitojmë trofe dhe të luajmë në Evropë", ka shtuar ai. Ish-kampionia e Kosovës, Drita, në ndeshjen e parë të edicionit të ri në elitë e pret të dielën nga ora 17:00 skuadrën e Ferizajt, kurse Shabani beson se fitorja nuk do të diskutohet. Sipas ish-mesfushorit të Feronikelit, Drita, duhet t'i marrë tri pikë nga kjo ndeshje për ta nisur kampionatin me hap të mbarë. "Ndeshjen e parë në kampionat e kemi ndaj Ferizajt. Ne do të hyjmë në këtë ndeshje për fitore, pasi një gjë e tillë do të na ndihmonte për ndeshjet në vijim. Kundërshtari ka skuadër të mirë, por ne luajmë në fushën tonë dhe besojmë në tri pikë për ta nisur kampionatin me këmbë të mbarë", ka deklaruar Shabani.

Skuadra e Dritës edicionin e fundit e mbylli në pozitën e katërt, duke mos arritur ta mbrojë titullin e kampiones, kurse e pasuksesshme ishte edhe në garë e Kupës. Drita së bashku me kampionin aktual, Feronikelin, Prishtinën dhe Gjilanin, po shihen si skuadrat favorite në garën për titull, por edhe për Kupë. Drita në këtë afat kalimtar bëri transferime shumë cilësore si Hamdi Namani, Faton Maloku dhe Izair Eminin. Këtyre i janë bashkuar edhe Ilir Blakçori, Viktor Kuka, Drilon Islami, Donat Hasanaj, Darko Tofiloski, Gilberto Fortunato dhe Bunjamin Shabani. Nga kjo skuadër janë larguar lojtarët që edicionin e kaluar kanë qenë titullarë të padiskutueshëm si Haxhi Neziraj, Endrit Krasniqi, Kyrian Nwabueze, Klajdi Burba, por edhe Mario Kirev, Zgjim Mustafa, Filonit Shaqiri dhe Përparim Livoreka.

SHKURT

Tifozët e Shkëndijës kundër Bylbyl Sokolit

Lajmi i publikuar në gazetën "Lajm" të Maqedonisë së Veriut, se Bylbyl Sokoli, trajneri i njohur nga Kosova, mund ta zëvendësojë Qatip Osmanin në bankinën e Shkëndijës, ka ngjallur reagime negative te tifozët e shumtë të Shkëndijës nëpër rrjete të ndryshme sociale. Pjesa dërrmuese e komentuesve janë shprehur kundër ardhjes së Sokolit në krye të stafit teknik të Shkëndijës. Sipas shumicës së komentuesve, Sokoli nuk është trajner i duhur për t'i drejtuar kuqezinjtë nga Tetova, ndërsa disa prej tyre kujtojnë një deklaratë të tij kundër tifozëve të Shkëndijës derisa ishte trajner i Renovës. Ndërkohë, nga burime brenda klubit tetovar mësojmë se drejtuesit e skuadrës nuk kanë diskutuar fare për angazhimin e trajnerit të njohur Bylbyl Sokoli. Kujtojmë se para shumë vjetësh Sokoli ka udhëhequr Shkëndijën, por edhe Renovën, Bashkimin dhe Milanon nga Kumanova.

Qallaku vazhdon me KB Rahoveci

KB Rahoveci ka konfirmuar se Arian Qallaku ka nënshkruar kontratë të re, me ç'rast do të jetë pjesë e klubit edhe për një sezon tjetër. "Arian Qallaku me kontratë të re. Edhe një sezon më tepër", thuhet në postimin e KB Rahoveci.

Gjilani, ofertë joshëse për Ylli Shametin

"Hajde firmos me ne, do të japim më tepër sesa merrje te Kukësi". Gjilani i Gentian Mezanit nuk njeh limite në merkaton e verës. Pasi ka "rrëmbyer" disa lojtarë cilësorë të kampionatit shqiptar, së fundmi klubi kosovar i ka bërë një ofertë shumë joshëse ish-kapitenit të Kukësit, Ylli Shameti. "Panorama Sport" zbulon nga burime të sigurta pranë klubit kosovar, se ditët e fundit drejtuesit e Gjilanit kanë pasur bisedime konkrete me Shametin. Mësohet se ky i fundit ka kërkuar një shifër të majme për ardhjen dhe një pagë që shkon thujase sa ajo që merrte te Kukësi në sezonin e fundit (pesë milionë lekë të vjetër në muaj). Megjithatë, asgjë nuk është e sigurt, pasi parësore për qëndrmbrojtësin është të qëndrojë në kampionatin shqiptar. Përveç ekipit të vendlindjes, Luftëtari, që i ka bërë një ofertë zyrtare, Shameti ka sinjale edhe nga Tirana, por pa u futur në detaje.

Driton Kuka i bashkohet AAK-së

PRISHTINË, 14 GUSHT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar se sot është jashtëzakonisht i nderuar

me vendimin e Driton Kukës për t'iu bashkuar AAK-së. Haradinaj ka thënë se Driton Kuka është një ndër heronjtë e sportit tonë, trajner i suksesshëm dhe merituar që Kosova ka fituar qindra medalje të arta

në xhudo, që t'i bashkohet familjes së madhe të Aleancës. "I pakomprometuar në asnjë aspekt ai, pos që ngriti yjet e përmasave globale dhe arriti t'i sjellë Kosovës Medaljen e Artë Olimpikë, është i biri i Ali Kukës,

kryetarit të parë të nëndegës së AAK-së në Pejë '2 Korriku'. I lumtur që edhe një anëtar i familjes së respektuar atdhetare Kuka, po e vazhdon traditën me Aleancën. Na priftë e mbara!", ka shkruar Haradinaj.



Hoxhaj lë Elbasanin për Vushtrinë

VUSHTRRI, 14 GUSHT - Nertil Hoxhaj është futbollisti i radhës nga Shqipëria që zbankon në Kosovë. 22-vjeçari i lindur në Fier e ka përforcuar skuadrën e Vushtrisë, e cila në këtë edicion bën gara në IPKO Superligën e Kosovës

në futboll. Hoxhaj është formuar te KF Partizani i Tiranës, klub me të cilin debutoi në maj të vitit 2016. Mbrojtësi i majtë, me t'u mbyllur sezoni në janar të vitit 2017, mori një ofertë nga KF Flamurtari i Vlorës ku pas

qëndrimin gjashtëmuor transferohet në KF Bylisit, ku dha kontributin që të renditen kampionë në tabelë, por në grup të "play-off"-it kishin Tiranën dhe nuk ia arritën të inkuadrohen në Superiore. "Pas aventurës në

KF Bylis, Hoxhaj së fundi transferohet në KF Elbasani, ku pas qëndrimin një vjeçar, përfundon kontratën për të filluar një aventurë të re me ne, në Superligën e Kosovës", thuhet në njoftimin e Vushtrisë.



Max Rugova bëhet 'bardhekaltër'

PRISHTINË, 14 GUSHT - FC Prishtina e ka transferuar futbollistin Max Rugova, i cili është djali i Edmond Rugovës, ish-golgeterit të Prishtinës, drejtor i klubit dhe seleksionues i Kosovës. Max Rugova ka lindur në Kansas të ShBA-së në vitin 2000, kurse është i gjatë 188 cm dhe luan në pozitën e sulmuesit të krahut. Rugova ka luajtur në Sporting Kansas City dhe në U19 të Nürnbergut më 2018/19 duke zhvilluar 16 ndeshje duke shënuar 1 gol. Max ka qenë i grumbulluar edhe me U19 të Kosovës. "Jam shumë krenar që do të jem pjesë e Prishtinës. Gjithmonë kam pasur dëshirë të jem në Prishtinë, sepse e di historinë e klubit ku ka luajtur babai im dhe e përsëris, kjo më bën krenar. Nuk dua të flas shumë për vete, megjithëse mendoj se jam shumë kreativ, duke e dashuruar driblimin dhe dëshirën, sidomos për asistime", ka thënë Rugova. "Ka disa ditë që jam me skuadrën, e njoh tani ekipin, ka një trajner të respektueshëm dhe kam krijuar besimin se ky ekip mund ta



fitojë titullin dhe shpresoj shumë ta mposhtë edhe konkurrencën e madhe brenda skuadrës që edhe unë të mund të kontribuoj për suksesin e ekipit", ka shtuar Max Rugova.

Fury: Amerika po dashurohet në mua, së shpejti kampion

LAS VEGAS, 14 GUSHT - Boksieri britanik Tyson Fury do të rikthehet në ring më 14 shtator, ku do të dublojë ndaj suedezit Otto Wallin në Las Vegas, sfidë e vlefshme për peshën e rëndë. Kjo sfidë do të jetë një përparim për ish-kampionin e botës, që synon të përballet sërish me kampionin aktual të peshës së rëndë Deontay Wilder (mban titullin e kategorisë WBC). Sfidat e parë mes Wilderit dhe Furyt, zhvilluar në dhjetor të 2018-s në Los Anxhelos, u mbyll bars. Ndaj, Fury shpreson që në revanshin ndaj amerikanit të mos gabojë sërish. "Nuk do ta përsëris gabimin e herës së fundit. E di mirë se nëse më duhet të shpallim sërish kampion bote, duhet ta fitoj këtë duel ndaj Wilderit me KO", ka thënë Fury. Duke folur për duelin ndaj suedezit Wallin, boksieri britanik shprehet se ka



nisur prej kohësh përparimet dhe se së shpejti do të jetë në Amerikë. "Kam dueluar në Los Anxhelos, Nju Jork dhe tani në Las Vegas. Amerika po

dashurohet në mua. Do të triumfoj edhe në këtë shtet, do të tregoj se kush jam. Nuk kam qenë kurrë më në formë se sot", ka deklaruar Fury.

SHKURT

Leclerc: Ky është problemi im me Ferrarin

Charles Leclerc është piloti i së ardhmes te Ferrari. 21-vjeçari debutoi këtë sezon me "kokëkuqen" në Formula 1, por ende nuk ka arritur asnjë fitore. Disa episode jo në favor e kanë dënuar që ta korrë suksesin e parë në karrierë. Piloti 21-vjeçar, duke bërë një përmbledhje të gjysmës së parë të kampionatit, shpjegon disa nga vështirësitë që ka hasur. "Mendoj se kam ende për të mësuar shumë në lidhje me menaxhimin e gomave, aty ku Vetteli ka më shumë përvojë se unë", ka thënë Leclerc. "Problemi im më i madh këtë sezon është pa dyshim ai me gomat. Kjo varet edhe nga mënyra se si unë pilotoj. Ndoshta pilotoj në mënyrë agresive dhe i konsumoj shumë, ndaj duhet të kuptoj më shumë se si t'i menaxhoj ato dhe të jem më pranë fitores", ka shtuar Leclerc.

Monaco e merr Yedderin në vend të Falcaos

Radamel Falcao pritet të largohet nga Monaco në këtë afat kalimtar, derisa skuadra franceze nuk ka humbur kohë dhe e ka gjetur zëvendësuesin e tij. Bëhet fjalë për sulmuesin Wissam Ben Yedder, i cili ishte pjesë e Sevillas. Monaco e ka paguar dëmshpërblimin prej 40 milionë eurosh, ndërsa sulmuesi ka nënshkruar një kontratë pesëvjeçare. Yedder ka shënuar për Sevillan 70 gola në 138 paraqitje, kurse ishte transferuar në Spanjë nga Toulouse në vitin 2016.

Van de Beek nuk e lë Ajaxin për Realin

Donny Van de Beek nuk do të largohet nga Ajaxi edhe pse interesim për shërbimet e tij ka shfaqur Real Madridi. Lajmi është konfirmuar nga drejtori sportiv i "Harkëtarëve", Marc Overmars. "Besoje se van de Beek do të qëndrojë tek Ajaxi", ka thënë ai. "Los Blancos" e konsiderojnë mesfushorin alternativë për ta përforcuar repartin e mesfushës, ku zgjedhje e parë ishin Paul Pogba dhe Christian Eriksen.

Barça ofertë të 'çmendur' për Neymarin

E kërcënuar nga rivaliteti i Real Madridit, Barcelona ka bërë një ofertë për të rikthyer në "Camp Nou" brazilianin Neymar. Sipas mediave franceze, Barcelona ka ofruar 80 milionë euro dhe Coutinho për ta marrë Neymarin. Siç raportohet, ka pasur takime mes drejtuesve të dy ekipeve. Barcelona po kërkon me ngulm ta rikthejë Neymarin dhe në qoftë se Parisi nuk bie dakord me ofertën e parë, Barça mund ta sakrifikojë edhe mesfushorin kroat Rakitiq ose mbrojtësin e djathtë Semedo. Pas dështimeve në kompeticionet evropiane, 27-vjeçari ka shprehur dëshirën për t'u larguar nga PSG-ja dhe për t'u rikthyer në Spanjë. Real Madridi po konkurren Barcelona në këtë transferim, saqë mediet franceze përpara dy ditëve e bënin të kryer kalimin e tij tek "Los Blancos".

Zbulohen hollësi të reja nga vdekja e Emiliano Salas

Emiliano Sala ishte ekspozuar ndaj një niveli të dëmshëm të monoksidit të karbonit, përderisa po udhëtonte me aeroplanin që u rrëzua mbi Kanalin Anglez në janar. Këtë lajm e bënë të ditur hetuesit. Në janar sulmuesi argjentinas Emiliano Sala vdiq gjatë udhëtimit nga Nantesi në Cardiff, pasi e kompletoi transferimin e tij në Cardiff City për 15 milionë funte, që theu rekordin e klubit. Ai dhe piloti David Ibbotson, trupi i të cilit nuk është gjetur ende, ishin të vetmit njerëz në atë aeroplan. Një raport i lëshuar nga Dega e Hetimeve të Aksidenteve Ajrore (AAIB) ka zbuluar se dyshja i ishte ekspozuar një gazi vdekjeprurës. Kjo u mësua pas testeve të gjakut që iu bënë Salahut. "Testet e toksikologjisë së gjakut të pasagjerit treguan se ai e kishte gjakun 58 për qind të ngopur me monoksid karboni. Ngopja me mbi 50 për qind të kësaj molekule konsiderohet fatale të cilido individ i shëndetshëm", thuhet në raportin e lëshuar nga AAIB. Futbollisti 28-vjeçar kishte qenë duke udhëtuar atë ditë, më 21 janar, pasi e kishte kompletuar transferimin nga Nantesi në Cardiff City. Aeroplani u gjet tri javë pasi ishte rrëzuar. Përderisa trupi i



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova -
Kosovo Agency of Statistics*

Duke u bazuar ne Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Procedurat e Rekrutimit ne Shërbimin Civil te Republikës se Kosovës , *Agjencia e Statistikave të Kosovës* shpallë:

KONKURS

I. Departamenti i Metodologjisë dhe TI-së një (1) pozitë të karrierës:

Titulli: Titulli: Një (1) Zhvillues dhe Administrator i Lartë i Sistemeve Softuerike

Numri i referencës: ASK-DMTI-se -001

Koeficienti: 8

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Zhvillon dhe implementon aplikacionet e reja, sistemet softuerike - programet, dhe/ose përmirësimin e aplikacioneve ekzistuese në kuadër të ASK-së;
- Sigurohet që aplikacionet e zhvilluara përmbushin kërkesat dhe objektivat e ASK-së, të përmbushë kërkesat e shfrytëzuesve të fundit, identifikon dhe zgjidhë problemet/çështjet e sistemeve;
- Siguron dizajnin, implementimin dhe testimin e softuerit të zhvilluar, përcjellë praktikën dhe standardet e softuerit në bazë të kërkesave të punës në ASK;
- Merr pjesë aktive në fazat para-testuese të zhvillimit duke vlerësuar propozimet me qëllim të identifikimit të fushave potenciale për probleme dhe bën rekomandimet e duhura;
- Planifikon, ekzekuton dhe menaxhon integrimin e aplikacioneve të reja në sistemet ekzistuese dhe softuerëve në kuadër të ASK-së,
- Koordinon punën me administratorë të rrjetit dhe me administratorë të bazës të të dhënave, të sigurojë funksionim të plotë të infrastrukturës dhe për të asistuar në sigurimin e kualitetit/cilësisë, logjikën e programeve dhe procesimin e të dhënave;
- Identifikon dhe krijon procedura për azhurnimin e aplikacioneve dhe rregullimin/evitimin e problemeve (bug fix);
- Krijimi dhe mirëmbajtja e kopjeve rezerve (backup) dhe përgatit procedurat për restaurimin e tyre (skenarët për backup dhe restore); si dhe punët tjera shtesë të cilat kërkohen nga udhëheqësi i divizionit.

-Kualifikimi : Diplome Universitare ne fushën e Teknologjisë Informative apo te ngjajshme.
-Përvoja e punës: Kandidati duhet ti ketë 3 vite përvojë profesionale në: ASP.NET MVC, VB .NET , C#;Përvoja që kanë të bëjnë me sistemin e bazës së të dhënave MS SQL Server;

-Kompetenca dhe aftësitë:

-Certifikata shtesë nga fushat e Teknologjisë Informative që ndërlihen e qe është e rëndësishme që zhvilluesi i sistemeve të ketë talentin dhe aftësinë për të mësuar teknologji të reja dhe të zbatojnë ato me sukses;
-Shkathtësi në planifikim, hulumtim dhe analiza, kapacitet për të udhëhequr proceset, për të koordinuar dhe organizuar punët, për të motivuar kolegët dhe për të punuar në atmosferë interdisciplinare;
-Njohuri të avancuara të gjuhës angleze e obliguar.

2. Departamenti Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit një (1) pozitë të karrierës:

Titulli: Një (1) Zyrtar për statistika të mjedisit për emisionet "Gazrat Serrë"

Numri i referencës : ASK-DSBM-002

Koeficienti: 7

Detyrat dhe përgjegjësit :

- Përgatit metodologjinë e publikimit të "Gazrave Serrë".
- Ben mbledhjen e të dhënave, përfshirjen, procesimin, analizimin dhe publikimin e të dhënave të "Gazrave Serrë".
- Krijimin e bazës së të dhënave si dhe është përgjegjës për kontrollin dhe cilësinë e të dhënave.
- Zbaton rekomandimet e BE-se për prodhimin e emisioneve të "Gazrave Serrë".
- Llogaritjen e të dhënave sipas udhëzuesit, Software IP CCC 2006.
- Bashkëpunon me ekspertë ndërkombëtarë të fushës adekuate si dhe dërgimin e të dhënave në Eurostat, me anën e programit Edamis.
- Bën analizën dhe përpunimin e të dhënave për emisionet CO, CO2 ekuivalent, SO2, PM 2.5-PM 10 mikrogram m³, SOx, SO2, NOx, NO2, etj.).

- Publikimin e të dhënave për cmetimet nga sektorët si: Energjia, Bujqësia, Proccseve Industriale dhe Përdorimi i Produkteve, Pylltaria dhe nga sektori i Mbeturineve si dhe kryen detyra të tjera shtesë sipas kërkesës së eprorit të tij/saj

-Kualifikimi : Diplomë universitare nga Fakulteti i Biologjisë, Fakulteti Ekonomik apo të ngjajshme

-Përvoja e punës: Kandidati duhet të ketë 2 vite përvojë punc profesionale .

-Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi të punës në kompjuter (Word, PowerPoint, Excel, Access, SPSS etj),
- Aftësi të larta të punës në grup/ekip,
- Shkathtësi hulumtuese, analitike dhe vlerësuese profesionale,
- Njohje c gjuhës Angleze ,
- Entuziast, energjik dhe i gatshëm në kryerjen e detyrave me cilësi dhe në kohë.

3. Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit një (1) pozitë të karrierës:

-Titulli: Një (1) Zyrtar për statistika në Zyrën Rajonale të Prishtinës
Numri i referencës : ASK-DRA-003

Koeficienti: 6

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Sigurimin e formularëve, kontrollimi dhe plotësimi i formularëve të responenteve,
- Shpërndarja e formularëve dhe pranimin e tyre,
- Angazhimi në përcjelljen e çmimeve të produkteve të konsumit të gjerë ,
- Grumbullon , kontrollon dhe azhuron të dhënat e buxhetit familjar në regjionin e Prishtinës dhe të njëjtat ju përcjellë shërbimeve gjegjëse në ASK-së,
- Është i angazhuar në anketën e fuqisë punëtore,
- Angazhimi në regjistrimin e qarqeve statistikore ,
- Grumbullon , kontrollon dhe azhuron të dhënat e demografisë në regjionin e Prishtinës dhe të njëjtat ju përcjellë shërbimeve gjegjëse në Agjencinë e Statistikave të Kosovës,
- Per punen e vet i përgjigjet eprorit të vet.

-Kualifikimi : Shkolla e mesme , 3 vite përvojë pune në fushën administrative .

-Kompetenca dhe aftësitë:

- Njohja e kompjuterit (Word ,Excel,Outlook) ,
- Bashkëpunimi ne mënyrë ekipore e nevojshme,
- Të ketë aftësi të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave individuale statistikore.

-Shkathtësi ne realizimin e punëve dhe detyrave sipas planit vjetor te zyrës rajonale
-Shkathtësi të mira të komunikimit , përfshirë aftësinë për të interpretuar informata , dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;

Procedura e konkurimit:

Në Shërbimin Civilë kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës se Kosovës të moshës madhore ,të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, përgatitje të nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për zbatimin funksionit administrativ dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore qe e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja e Shërbyesve Civilë bëhet në pajtim me Ligjin –Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës se Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit ne Shërbimin Civilë.

Kohëzgjatja e emërimit: Sipas Ligjit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës , në të cilën është përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

Konkursi është i hapur 15 dite kalendarik nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencionin e Statistikave te Kosovës , Rr."Zene Salihu" nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, dëshmi mbi përvojën e punës profesionale , vertetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetime dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme , që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurroni.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do ti nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni me zyrën e personelit , në tel: 038- 20031149 , prej orës 08:00 – 16: 00.

"Shërbimi Civilë i Kosovës ofron mundësi të barabarta te punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

"Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës".



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister

*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova -
Kosovo Agency of Statistics*

Na osnovu Zakona Br. 03/Z-149 o Civilnoj Službi Kosova i Pravilnika Br.02/2010 o Procedurama Rekrutacije u Civilnoj Službi Republike Kosova, Agencija za Statistiku Kosova raspisuje:

KONKURS

1. Odeljenje Metodologije i IT-a, jedna (1) pozicija od karijere:

Naziv radnog mesta: Jedan (1) Programer/Developer i Viši Administrator Softverskih Sistema Numri i referencës : ASK-DMTI-se -001

Koeficienti : 8

Zadaci i odgovornosti:

- Razvija i implementira nove aplikacije, softverske sisteme - programe i / ili nadogradnju postojećih aplikacija unutar ASK-a;
- Osigurava da razvijene aplikacije ispunjavaju zahteve i ciljeve ASK-a, ispunjavaju zahteve krajnjih korisnika, identifikuju i rešavaju sistemska pitanja / probleme;
- Osigurava dizajn, implementaciju i testiranje razvijenog softvera, prati prakse i softverske standarde zasnovanih na zahtevima rada ASK-a;
- Aktivno učestvuje u fazama pred-testiranja razvoja procenjujući predloge kako bi se identifikovale potencijalna područja za probleme i daje odgovarajuće preporuke;
- Planira, izvršava i upravlja integracijom novih aplikacija u postojeće sisteme i softvera unutar ASK-a;
- Koordinira rad sa administratorima mreža i administratorima baza podataka kako bi se osigurala puna funkcionalnost infrastrukture i pomoglo u osiguravanju kvalitete, logika softvera i obrada podataka;
- Identifikuje i kreira procedure za ažuriranje aplikacija i popravljavanje/izbegavanje grešaka (bug fix);
- Kreira i održava rezervne kopije (backup) i priprema procedura za njihovu obnovu (scenarije za backup i vraćanje); kao i druge dodatne zadatke na zahtev šefa divizije.

Kvalifikacija : Univerzitetska diploma u oblasti informacionih tehnologija ili slično

Radno iskustvo: Kandidat mora imati 3 godine profesionalno radno iskustvo u: ASP.NET MVC, VB .NET , C#; Iskustvo sa sistemom baze podataka MS SQL Server;

Kompetenca dhe aftësitë:

- Dodatni sertifikat iz relevantnih oblasti informacionih tehnologija i koji je važna da programer/developer sistema da ima talenat i sposobnost da nauči nove tehnologije i da ih uspešno implementira;
- Veštine u planiranju, istraživanju i analizu, sposobnost vođenja procesa, koordiniranje i organizuje radove, da motiviše kolege i da radi u interdisciplinarnoj atmosferi;
- Napredni nivo poznavanje engleskog jezika, obavezno;

2. Department Poljoprivrede i zaštite životne sredine jedno (1) radno mesto:

Naslov: Jedan (1) službenik za statistiku zaštite životne sredine za emisije gasova sa efektom staklene bašte

Referentni broj: ASK-DSBM-002

Koeficijent: 7

Obaveze i odgovornosti:

- Pripremiti metodologiju za objavljivanje „Stakleničkih gasova“;
- Prikuplja, uključuje, obrađuje, analizira i objavljuje podatke o efektima staklene bašte;
- Stvaranje baze podataka i odgovorno je za kontrolu i kvalitet podataka;
- implementira preporuke EU za proizvodnju emisija gasova sa efektom staklene bašte;
- Proračun podataka prema smernicama, Software IP CCC 2006;
- Sarađivati sa međunarodnim stručnjacima u toj oblasti i slati podatke Evrostatu kroz program Edamis;
- Vrši analizu i obradu podataka za CO, ekvivalent CO₂, SO₂, PM 2,5-PM 10 mikrograma m SO, SO_x, NO_x, NOK, NO₂, itd.);
- Objavljivanje podataka o emisijama iz sektora kao što su: energetika, poljoprivreda, industrijski procesi i upotreba proizvoda, šumarstvo i sektor otpada, i vrši dodatne dužnosti na zahtev svog supervizora;

- **Kvalifikacija:** diploma sa Biološkog , Ekonomskog fakulteta ili slično
- **Radno iskustvo:** Kandidat mora imati 2 godine profesionalnog radnog iskustva

Kompetencije i sposobnosti:

- Kompjuter računarske veštine (Vord, PoverPoint, Ekcel, Access, SPSS itd.),
- Profesionalne veštine profesionalnog istraživanja, analitike i evaluacije,
- Ppoznavanje engleskog jezika;
- Entuzijastični, energični i spremni za izvršavanje kvalitetnih zadataka na vreme.

3. Department Odeljenje za registraciju i istraživanje jedan (1) pozicija u karijeri:

Naziv: Jedan (1) službenik za statistiku u Regionalnoj kancelariji u Prištini

Referentni broj: ASK-DRA-003

Koeficient : 6

Obaveze i odgovornosti:

- Davanje obrazaca, provjera i popunjavanje obrazaca za ispitanike;
- Distribucija obrazaca i njihovo prihvatanje;
- Posvećenost praćenju cena potrošačkih proizvoda;
- Prikuplja, kontroliše i ažurira podatke o porodičnom budžetu u regionu Prištine i prosleđuje ih nadležnim službama u ASK;
- Angažovana u istraživanju radne snage;
- Angažovanje u registraciji statističkih kola;
- Prikuplja, kontroliše i ažurira demografske podatke regiona Prištine i izveštava ih nadležnim službama Kosovske agencije za statistiku;
- Za svoj rad je odgovoran nadređenom.

- **Kvalifikacija:** Srednja škola. , i 3 godine administrativno radnog iskustva

Kompetencije i sposobnosti:

- Znanje program ano kompjutera (Vord, Ekcel, Outlook);
- potreban timski rad;
- Sposobnost održavanja poverljivosti pojedinačnih statističke podataka;
- Sposobnost u obavljanju zadataka prema godišnjem planu u regionalnim kancelarijem;
- Da ima dobre komunikacijske veštine, uključujući sposobnost tumačenja informacije, davanje uputstva i prosleđivanje informacija drugima.

Procedura e konkurimit:

U Civilnoj Službi imaju pravo da budu zaposleni punoletni državljani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, imaju potrebnu školsku spremu i profesionalne sposobnosti za sprovođenje administrativnih funkcija i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju

Zakoni i propisi kojima se reguliše zapošljavanje:

Izbir Civilnih Službenika vrši se u skladu sa Zakonom br . 03/Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova i Uredbom . 02/2010 o Postupku za Zapošljavanje u Civilnoj Službi.

Trajanje imenovanja: U skladu sa Zakonom o Civilnoj Službi Republike Kosova u kojem je predviđen period probnog rada u trajanju od jedne (1) godine.

Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja u javnim medijima.

Uzimanje i podnošenje aplikacija:

Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova , Ul. "Zene Salihu" br.4,Priština. Uz aplikacije potrebno je priložiti i kopije dokumenata o kvalifikacijama, dokaz o radnom iskustvu, potvrdu suda da osoba nije pod istragom i ostalu potrebnu dokumentaciju koja je potreba za radno mesto za koju se prijavljujete.

Zahtevi podneti posle roka konkursa neće biti prihvaćeni.

Zbog velikog broja primljenih prijava,samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani. Kandidati izabrani u uži izbor biće pismeno testirani i intervjuisani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju Osoblja na broj telefona: : 038- 200 31149 od 08:00 – 16: 00 časova.

“ Kosovska Civilna Služba pruža ravnopravnu mogućnost zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije svih lica muškog i ženskog pola iz svih nacionalnosti na Kosovu.”

“Ne-većinske nacionalnosti i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u centralnim i lokalnim organima civilne službe javne administracije, kako je specificirano u Članu 11, st. 3 Zakona Br. 03/Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova”.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration

MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ministria e Administratës Publike bën:

Shpallje të Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	Ministria e Administratës Publike / Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
Titulli i punës:	Përkthyes/e Shqip - Serbisht dhe anasjelltas (1 vende pune)
Titulli i punës:	Përkthyes/e Shqip - Anglisht dhe anasjelltas (1 vend pune)
Numri i referencës:	MAP/DFSHP - 8 - 2019 /MSHV
Tarifa e shërbimit:	Koeficienti 7
Raporton te:	Udhëheqësi i Divizionit
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	3-6
Orari i punës:	1 plotë, 40 orë në javë
Lokacioni:	Prishtinë "Ndërtesa ish Rilindja"

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përkthim profesional i materialeve zyrtare nga gjuha shqipe në serbe dhe anasjelltas; (për pozitën përkthyes/e Shqip - Serbisht dhe anasjelltas)
- Përkthim profesional i materialeve zyrtare nga gjuha shqipe në angleze dhe anasjelltas; (për pozitën përkthyes/e Shqip - Anglisht dhe anasjelltas)
- Përkthim simultant dhe konsektiv nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas në takime të niveleve të ndryshme të ministrisë; (për pozitën përkthyes/e Shqip - Serbisht dhe anasjelltas);
- Përkthim simultant dhe konsektiv nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas në takime të niveleve të ndryshme të ministrisë; (për pozitën përkthyes/e Shqip - Anglisht dhe anasjelltas)
- Përkthim konsektiv në seminare, komisione dhe takime të ndryshme etj;
- Përkthim administrativ duke shtypur në kompjuter në formë të drejtë drejtshkrimore;
- Korrigjon dhe dërgon shkresa e materiale sipas nevojave të Ministrisë;
- Protokolon materialet e përkthura në librin e regjistratit dhe i arkivon në mënyrë elektronike;
- Bashkëpunon me zyrtarët tjerë në përbushjen sa më të suksesshme të detyrave duke u konsultuar me eprorin;
- Ofron dhe kryen përkthime duke bashkëpunuar me njerëz të kulturave të ndryshme, besimeve fetare të ndryshme, kundër vështrimeve politike të mbajta paanësinë dhe objektivitetin;
- Të pranohet kushtet e vështira të komunikimit pa kufizim kohor në raste të përkthimeve të ndryshme;
- Të ketë njohuri në përdorimin e mjeteve për përkthim (teknikat e përkthimit);
- Kryen punë të tjera sipas kërkesës së eprorit;

Kualifikimi Përvoja dhe Shkathtësitë e kërkuara:

- Fakulteti i Filologjisë apo shkencë shoqërore;
- Së paku 2 vite përvojë pune profesionale;
- Zotim i shkëlqyeshëm i gjuhëve shqipe dhe serbe; (për pozitën përkthyes/e Shqip - Serbisht dhe anasjelltas);
- Zotim i shkëlqyeshëm i gjuhëve shqipe dhe angleze; (për pozitën përkthyes/e Shqip - Anglisht dhe anasjelltas)
- Shkathtësi komunikimi, në mënyrë verbale dhe në të shkruar, me qëllim që të jetë i aftë të komunikoj;
- Njohuri të mira të punës me kompjuter
- Aftësi në përbushjen e detyrave dhe punëve me ngarkesë, dhe përcaktimin prioriteteve;

Ministria e Administratës Publike mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim e të drejtave civile dhe politike, të kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit në ueb faqen e MAP-it dhe shtypin ditor.

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e MAP-it, zyrën nr.320 kati i III-të ose mund të tërhiqen nga ueb faqja e MAP-it në adresën <http://map.rks-gov.net/> dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: Ndërtesa e ish Rilindjes kati i III-të nr. zyrës 320 - Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 8:00 - 16:00. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/200 60-404.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Datat e mbajtjes së intervistave për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë konkurs, do të publikohen vetëm në ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Administratës Publike.

Na osnove člana 12, stav 4 Zakona Br. 03/ L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova, Zakon Br. 04/L-077 za Obligacione Odnose, Ministarstvo Javne Uprave, objavljuje:

Javni konkurs o Dogovoru za Posebne Usluge

Naziv Institucije	Ministarstvo Javne Uprave / Departman Finansija i Opštih Usluga
Titula radnog mesta :	Prevodilac Albanski - Srpski i obrnuto (1 radno mesto) Prevodilac Albanski - Engleski i obrnuto (1 radno mesto)
Broj referenci je :	MJU-DFOU - 8 - 2019 god./DPU
Tarifa usluge :	Koeficijent 7
Izveštava :	Rukovodilac Divizije
Vrsta Ugovora :	Dogovor za Posebne Usluge - (DPU)
Trajanje ugovora:	3-6
Radno vreme :	Puno radno vreme, 40 sati nedeljno
Lokacija	Prishtina "Bivši Dom Štampe Rilindja"

Zadaci i odgovornosti :

- Profesionalni prevod službenih materijala sa albanskog na srpskom jeziku i obrnuto; (za poziciju prevodilaca Albanskog - Srpskog jezika i obrnuto);
- Profesionalni prevod službenih materijala sa albanskog na engleskom jeziku; (za poziciju prevodilaca Albanskog - Engleskog jezika i obrnuto);
- Simultani i konsektivni prevod sa albanskog na srpskom jeziku i obrnuto na sastancima različitih nivoa ministarstva; (za poziciju prevodilaca Albanskog - Srpskog jezika i obrnuto);
- Simultani i konsektivni prevod sa albanskog na engleskom jeziku; (za poziciju prevodilaca Albanskog - Engleskog jezika i obrnuto);
- Konsektivni prevod na seminarima, komisijama i raznim sastancima itd.;
- Administrativni prevod kucanjem u kompjuteru u ispravnom pravopisu;
- Ispravlja i šalje dopise i materijale u skladu sa potrebama Ministarstva;
- Protokolira prevedene materijale u registarskoj knjizi i arhivira ih na elektronski način;
- Sarađuje sa drugim službenicima u uspešnom obavljanju dužnosti uz konsultacije sa nadzornikom;
- Pružna i obavlja prevode u saradnji sa ljudima različitih kultura, različitih religija, prema političkim stavovima da održava nepristrasnost i objektivnost;
- Da prihvati teške uslova komuniciranja bez vremenskog ograničenja u slučaju različitih prevoda;
- Imati znanja o upotrebi opreme za prevodjenje (tehnika prevodjenja);
- Vrši druge poslove na zahtev nadzornika;

Kvalifikacije Radno iskustvo i potrebne Veštine :

- Filološki Fakultet ili društvenih nauka.
- Najmanje 2 godine stručnog radnog iskustva;
- Odlčno vladanje albanskog i srpskog jezika; (za poziciju prevodilaca Albanskog - Srpskog jezika i obrnuto);
- Odlčno vladanje albanskog i engleskog jezika; (za poziciju prevodilaca Albanskog - Engleskog jezika i obrnuto);
- Veštine komuniciranja, usmeno i pismeno, da bi bio u stanje da komunicira;
- Dobro poznavanje rada sa kompjuterom
- Sposobnost ispunjavanja zadataka i poslova pod opterećenjem, i određivanje prioriteta;

Ministarstvo Javne Uprave dočekuje aplikacije iz svih osoba muškog i ženskog pola, iz svih zajednica.

Uslovi učestvovanja na konkurs:

Pravo apliciranja imaju svi Građani Republike Kosova punoletne starosti koji imaju punu pravnu sposobnost delovanja, civilnih i političkih prava, i imaju potrebnu obrazovnu i stručnu pripremu i sposobnost za obavljanje dužnosti, i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za određenu poziciju.

Datum zatvaranja konkursa: Konkurs je otvoren 8 kalendarskih dana od dana objavljivanja na web stranicu MJU- a i u dnevnoj štampi.

Podnošenje zahteva: Prijave za apliciranje se mogu uzimati na recepciji MJU- a, kancelarija br.320 III-ći sprat ili u web stranicu MJU-a u adresu <http://map.rks-gov.net/> i dostavljaju u Diviziju za Ljudske Resurse na adresu: bivši Dom štampe Rilindja III-ći sprat kancelarija br.320 - Prishtina, svakog radnog dana od 8:00 - 16:00 časova. Za detaljnije informacije možete nas kontaktirati na br. Tel. 038/200 30 002.

Uz aplikaciju treba priložiti i: Kopiju lične karte, kopije kvalifikacione dokumentacije, kao i druga potrebna dokumenta prema konkursu.

Datum održavanja intervjuja za kandidate koji ispunjavaju uslove predviđene u ovom konkursu, biće objavljen samo u službenoj web stranici Ministarstva Javne Uprave.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravstva – Ministry of Health
 Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
 Univerziteti i Kosovës – Klinička Služba Kosova –
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm, Opšta Bolnica, Genel Hastane, General Hospital
“Prim. Dr. DAUT MUSTAFA”
Prizren



03/L-212 sayılı Çalışma Kanununun 8. maddesine dayanarak, HKÜH'nun konkur işlemlerini düzenleyecek 07/2017 sayılı İdari Yönerge'nin, 10. maddesine, 04/L-125 Sağlık Kanunu'nun 62 maddesinin 6 fıkrası uyarınca, HKUK Genel Müdürü tarafından 18.06.2019 tarihinde onaylanan 13.06.2019 tarihli ve 02/132 sayılı işe alım talebi, aynı zamanda Hastane statüsününün 13. maddesi 1.1 fıkrasına göre Genel Hastane Yönetim Kurulu sunu ilan eder:

KAMU İŞ İLANI

Işe alım için:

Görev unvanı:

1. Genel hemşirelik lisansı (bachelor): 5 konum

Maaş katsayısı: 5.40

Çalışma standardı: Tam iş süresi

Sözleşme süresi: Süresiz deneme süresi ile 3 (üç) ay

Temel sorumluluklar: Sağlık hizmetlerinin, profesyonel nezaket seviyesine dayanan niteliksel ve niceliksel bir şekilde sunulması, hasta ve çalışan personele özen ve saygı gösterilmesi.

2. Ebe lisansı (bachelor): 5 konum

Maaş katsayısı: 5.40

Çalışma standardı: Tam iş süresi

Sözleşme süresi: Süresiz deneme süresi ile 3 (üç) ay

Temel sorumluluklar: Sağlık hizmetlerinin, profesyonel nezaket seviyesine dayanan niteliksel ve niceliksel bir şekilde sunulması, hasta ve çalışan personele özen ve saygı gösterilmesi.

3. Temizlikçi: 2 konum

Maaş katsayısı: 4

Çalışma standardı: Tam iş süresi

Sözleşme süresi: Süresiz deneme süresi ile 3 (üç) ay

Temel sorumluluklar: Bölümlerin ve birimlerin ihtiyaçlarına göre, özellikle de yukarıdakini önem vererek, nitel ve nicel anlamda hizmet sunmak.

4. İdari işçisi: 1 konum

Maaş katsayısı: 4

Çalışma standardı: Tam iş süresi

Sözleşme süresi: Süresiz deneme süresi ile 3 (üç) ay

Temel sorumluluklar: Taşıma ve otomatik park ünitesine özellikle önem vererek, bölümlerin ve birimlerin ihtiyaçlarına göre nitel ve nicel anlamda hizmet sunmak.

Referans numarası: 8/33, datë; 09.08.2019

1. İşe alım için gerekli şartlar Genel hemşirelik lisansı (bachelor): Tamamlanan üniversite – Genel hemşirelik

Gerekli belgeler:

1. Tıp fakultesi diploması, genel hemşirelik bölümü – (orjinal veya onaylı kopya)
2. Sağlık bakanlığı tarafından verilen çalışma izni geçerlidir (orjinal veya onaylı kopya)
3. Doğum belgesi (orjinal veya onaylı kopya) ve kimlik kartı fotokopisi
4. Hükümlü ve soruşturma altında olmadığınızı gösteren belge (orjinal veya onaylı kopya)
5. Sağlık durumu raporu (ise alındıktan sonra)

2. İşe alım için gerekli şartlar ebe lisansı (bachelor): Tamamlanan üniversite – Genel hemşirelik

Gerekli belgeler:

1. Tıp fakultesi diploması, ebellek bölümü – (orjinal veya onaylı kopya)
2. Sağlık bakanlığı tarafından verilen çalışma izni geçerlidir (orjinal veya onaylı kopya)
3. Doğum belgesi (orjinal veya onaylı kopya) ve kimlik kartı fotokopisi
4. Hükümlü ve soruşturma altında olmadığınızı gösteren belge (orjinal veya onaylı kopya)
5. Sağlık durumu raporu (ise alındıktan sonra)

3. İşe alım için gerekli şartlar temizlikçi: orta okul

Gerekli belgeler:

1. Lise bitimine dair sertifikası
2. Doğum belgesi (orjinal veya onaylı kopya) ve kimlik kartı fotokopisi
3. Hükümlü ve soruşturma altında olmadığınızı gösteren belge (orjinal veya onaylı kopya)
4. Sağlık durumu raporu (ise alındıktan sonra)

4. İşe alım için gerekli şartlar idari işçisi: orta okul

Gerekli belgeler:

1. Lise bitimine dair diploma
2. Doğum belgesi (orjinal veya onaylı kopya) ve kimlik kartı fotokopisi
3. Hükümlü ve soruşturma altında olmadığınızı gösteren belge (orjinal veya onaylı kopya)
4. Sağlık durumu raporu (ise alındıktan sonra)

Tüm pozisyonlar için işe alım şartları: Yeterli eğitimi tamamlamış ve başvurdukları iş başvurusunda bulunmaya uygun olan tüm Kosova Cumhuriyeti vatandaşları başvuru yapabilir. İş ilanı, kamusal medyada yayınlandığı tarihten itibaren 15 gün açık kalacaktır. Başvurular Hastane İdaresinden alınmaktadır. Ekli belgelere sahip başvurular Prizren hastane idaresine, "Sheh Emiri" sokakına her iş günü 7:00-15:00 saatlerinde gönderilir. Son başvuru tarihinden sonra sunulan başvurular kabul edilmezken, eksik başvurular reddedilir.

Prizren, 09.08. 2019

Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti
 Ministria e Shëndetësisë
 Ministarstvo Zdravstva - Sağlık Bakanlığı
 SHSKUK - UBKSK - KUHKH
SPITALI I PËRGJITHSHËM-OPŠTA BOLNICA-GENEL HASTANE
“Prim. Dr. Daut Mustafa”

Njësia Org. _____ Nr. Prot. _____
 Org. Jedinica _____ Br. Prot. _____
 Org. Bölümü _____ Prot. No. _____
 Nr. i faqeve _____ Datum: _____
 Br. stranica _____ Tarih: _____
 Sayfa no. _____ P R I Z R E N

Idare Direktori
 Mas. Melinda Çollaku



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook www.facebook.com/giejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Banesë me qira në Dardani për çif bashkëshortësh. Banesa ka 50 m2 me një dhomë gjumi, sallone dhe kuzhinë, banjo dhe ballkon dhe shpajz. Kati i 7 me lift. Çmimi 250 Euro kontakti 044-171328.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallone me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallone me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallone dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.
- ▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

